

Teza e magjistraturës

“Kontrata konsumatore në Republikën e Maqedonisë së Veriut-rasti i kontratave të lidhura nga
Ndërmarrja Publike-Ujësjetësi dhe kanalizimi, Shkup në periudhën 2015 e këndej”

Mentori:

Prof.dr.Adnan Jashari

Kandidate:

Semia Orana

Përmbajtja

ABSTRAKT	5
I.TEORIA E PËRGJITHSHME E KONTRATËS	6
I.1. KUPTIMI.....	6
I.2 FUSHA E ZBATIMIT	7
I.3. TERMINOLOGJIA	8
I.4. RËNDËSIA E KONTRATËS	8
II. PARIMET E SË DREJTËS KONTRAKTORE.....	9
II.1 LIRIA E KONTRAKTIMIT	9
II.1.1 Kuptimi	9
II.1.2 Anatomia e vullnetit –.....	9
II.1.2 Pasojat e mësimi të tillë	10
II.1.3 Autonomia e vullnetit dhe dispozitat ligjore.....	10
II.1.4 Kritika e teorisë së autonomisë së vullnetit	10
II.1.5 Kufizimi i lirisë së kontraktimit.....	11
II.1.6 Përfundimi.....	11
II.2 PARIMI I KONSENSUALIZMIT	11
II.2.1 Kuptimi	12
II.2.2 Zhvillimi i këtyre rregullave	12
III KUSHTET PËR LIDHJEN E KONTRATËS	13
III.1.1 Aftësia punuese e palëve	13
III.1.3 Lënda e kontratës.....	16
III.1.3.1 Lënda duhet të jetë e mundshme	16
III.1.3.2 Lënda e kontratës duhet të jetë e caktuar ose e caktueshme.....	17
III.1.3.3 Lënda e kontratës duhet të jetë e lejuar	17
III.1.4 Baza e kontratës	17
III.1.4.1 Kuptimi:.....	17
III.1.4.2 Mendime rreth bazës së kontratës:	17
III.1.4.3 Baza në disa kontrata:.....	18
III.1.4.4 Rëndësia e bazës së kontratës:.....	19
III.1.4.4.1 Mungesa e bazës së kontratës	19
III.1.4.4.2 Baza është fiktive.....	19
III.1.4.4.3 Baza e ndaluar	20

III.1.4.4.4 Pasojat juridike të mungesave të bazës së kontratës:	20
III.1.4.4.5 Motivimi i kontratës:	20
III.2 KUSHTET E VEÇANTA PËR LIDHJEN E KONTRATËS.	21
III.3 FORMA E KONTRATËS	22
IV. Sfondi i evoluimit historiko-ligjor i së drejtës së konsumatorit dhe kontratave konsumatore.E drejta e konsumatorit si multidisiplinë juridike.	23
IV.1 Sfondi historik i evoluimit të së drejtës së konsumatorit dhe kontratatve konsumatore...	23
IV.2 Koncepte të përgjithshme mbi kontratat dhe të drejtën e konsumatorit.	24
IV.3 E drejta e konsumatorit si multidisiplinë dhe raporti i saj me degët e tjera të së drejtës..	25
IV.3.1 Subjektet e së drejtës së konsumatorit.....	26
IV.4 Konsumatori.....	26
IV.5 Tregtarët.....	29
IV.6 Përmbajtja e së drejtës së konsumatorit	31
IV.6.1 Të drejtat e konsumatorëve	31
IV.6.2 Detyrimet e tregtarëve	32
V. Kontratat e Posaçme në të drejtën e konsumatorit.....	33
V.1 Shitja dhe ofrimi i shërbimit jashtë qendrave të tregtimit.....	33
V.2 Shitja dhe ofrimi i shërbimit në largësi	35
V.3 E drejta për të hequr dorë nga kontrata	37
V.4 Nevoja e mbrojtjes së konsumatorit	38
V.5 Parimet e Bashkimit Europian për Mbrojtjen e Konsumatorit.....	39
V.6 Parashikime të përgjithshme të Direktivës “Mbi Kushtet e Padrejta në Kontratat Konsumatore”.....	40
V.7 Fusha e zbatimit të Direktivës mbi Kushtet e Padrejta	41
V.8 Nivel më i lartë i mbrojtjes së konsumatorit.	41
V.9 Përkufizimi i konsumatorit.....	42
V.10 Përkufizimi i shitësit ose furnizuesit	43
V.11 Kushtet e negociuara individualisht	45
VI. Mosmarrëveshjet në të drejtën e konsumatorit.....	46
VI.1 Mosmarrëveshjet në të drejtën e konsumatorit që prekin interesin individual të konsumatorit.....	46
VI.1.1 Aksesimi në drejtësi i konsumatorit.	47
VI.1.2 Mjetet alternative jashtëgjyqësore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në të drejtën e konsumatorit.	48

VI.1.2.1 Ndërmjetësimi.	48
VI.1.2.2 Arbitrazhi.....	48
VI.1.2.3.1 Kompetenca ligjore.	49
VI.1.2.3.2 Kompetenca tokësore.	50
VI.1.3 Mjetet juridike mbrojtëse të konsumatorit.	51
VI.2 Mosmarrëveshjet në të drejtën e konsumatorit që prekin interesin kolektiv të konsumatorit.....	51
VI.2.1 Mbrojtja e interesit kolektiv të konsumatorëve nga organet e administratës shtetërore.	52
VI.2.3 Mbrojtja e interesit kolektiv të konsumatorëve në gjykatë.	53
KONTRATAT KONSUMATORE NDËRMJET N.P UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI DHE PALËVE TJERA KONTRAKTUESE	62
Dokumenti i parë:.....	62
Dokumenti i dytë:.....	62
Dokumenti i tretë:.....	62
PËRFUNDIMI	63
Literaturë e shfrytëzuar	64

ABSTRAKT

Në këtë temë tentova të diskutoj lidhur me rëndësinë e konsumatorit si kategori mjaft relevante lidhur me marrëdhëniet që krijohen ndërmjet individëve në shoqëri, posaçërisht në marrëdhëniet e tilla kontraktuese. Si çështje e rëndësishme dhe pararendëse doemos e kam të flas për institutin me të cilin shprehet vullneti dypalësh në këto marrëdhënie, e që bëhet fjalë për kontratën.

Në këtë kontekst bëra sqarimin lidhur me teoritë e përgjithshme të kontratës si institut relevant juridiko-detyrimor, njëkohësisht sqaruam edhe kuptimin dhe definimin e kontratës, fushën e zbatimit të së njejtës, terminologjinë e kontratës duke pasur parasysh se ky institut mund të emërohet në forma të ndryshme por që esenca është e njejtë dhe i vetmi dallim qëndron tek subjektet të cilët janë pjesëmarrës për lidhjen e kontratës dhe si pjesë relevante sqarova rëndësinë e kontratës.

Nuk mund të flasim për kontratë në rast se e njehta nuk i'u është përmbajt parimeve në korniza të së cilës sëndërtohet kontrata dhe ato janë liria e kontraktimit, që kemi biseduar rreth kuptimit të lirisë së kontraktimit rreth teorisë së autonomisë së vullnetit dhe rreth kufizimit të lirisë së kontraktimit dhe parim tjetër është parimi i konsensualizimit që njëkohësisht kemi biseduar rreth kuptimit të parimit të konsensualizimit dhe rëndësisë së këtij parimi. Pjesë tjetër është pjesa e kushteve për lidhjen e kontratës, ku sqarim të hollësishëm i kemi dhënë aftësisë punuese të palëve, lëndës së kontratës, bazës së kontratës dhe motivi i kontratës si dhe për kushtet e veçanta për lidhjen e kontratës.

Rëndësi të veçantë ka të bëjë lidhur me historikun ligjor të së drejtës së konsumatorit dhe kontratave të konsumatorit si dhe koncepte të përgjithshme mbi kontrata dhe të drejtën e konsumatorit, lidhur me subjektet e së drejtës së konsumatorit që janë tregtarët dhe konsumatorët, përmbajtjen e së drejtës së konsumatorit si dhe të drejtat e konsumatorëve dhe detyrimet e tregtarëve.

Kam treguar lidhur me kontratat e posaçme lidhur me të drejtën e konsumatorit, nevojën e mbrojtjes së konsumatorit si dhe përparimet e Bashkimit European për mbrojtjen e konsumatorit, si mosmarrëveshjet që paraqiten në të drejtën e konsumatorit , poashtu edhe për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve duke u thirur në instrumentet përkatëse lidhur me tejkalimin e këtyre mosmarrëveshjeve.

I.TEORIA E PËRGJITHSHME E KONTRATËS

I.1. KUPTIMI

Kontrata është burim material i së drejtës së detyrimeve . Ajo është marrëveshje e dy apo më tepër personave me të cilën krijohet, ndryshohet ose shuhet një marrëdhënie detyrimi. Në doktrinën juridike të të drejtave nacionale zakonisht thuhet se kontrata është marrëveshje e dy ose më tepër personave me të cilën krijohen pasojat e caktuara juridike .¹ Ajo është punë(akt , veprim) juridike e dyanshme, sepse krijon efekte juridike si për njërën ashtu edhe për anën tjetër kontraktuese. Kontrata është marrëdhënie juridike (vinculum iuris) rregullar sipas të drejtës . Kjo marrëdhënie juridike mund të jetë me shpërblim apo pa shpërblim, me theks se në shumicën e rasteve ajo është me shpërblim.Kjo është e kuptueshme, sepse rregullat e së drejtës së detyrimeve në shumicën e rasteve përkrahin karakterin me shpërblim të këtyre marrëdhënieve, duke qenë se këto marrëdhënie zakonisht krijojnë marrëdhënie që janë shumë afër marrëdhënieve të drejta në qarkullim.²

Kur thuhet se kontrata është punë juridike me atë anë të së cilës dy ose disa persona e krijojnë, e ndryshojnë ose e shuajnë një marrëdhënie juridike. Kjo punë juridike është e dyanshme, që nga ana tjetër dallohet nga punët juridike të njëanshme. Dallimi midis punëve juridike të njëanshme dhe dyanshme bëhet sipas asaj se sa persona kanë shprehur vullnetin e tyre. Ndërkaq ndarja e kontratave të njëanshme dhe të dyanshme detyruese bëhet sipas të drejtave dhe detyrave që u krijohen palëve kontraktuese. Në praktikë kështu është për rastin e parë kur bëhet oferta, te premtimi botërisht i shërbimit, kurse për rastin e dytë te dhurata dhe te shitja.Kontrata (contractus) si burim me rëndësi i së drejtës së detyrimeve është institucion i kësaj dege të së drejtës , pra edhe i të drejtës civile. Me anë të kontratës krijohen detyrimet, ndryshohen ato, madje edhe mund të shuhen . Në aspektin praktik dhe teorik kontrata më me rëndësi janë ato që krijojnë detyrime midis personave fizië, midis personave juridikë dhe pjesëmarrësve të tjerë tëmundshëm . Me fjalë tjera, me anë të kontratës rregullohen marrëdhëniet e pjesëmarrësve në

¹Dr Andon Sallabanda: E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 1961.

² Dr Alajdin Alishani: E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 1989, fq 185

qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve .Rregullat e organizimit juridik të kontratës dhe rrjedhave të saja janë përshtashme, fleksibile në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve.

I.2 FUSHA E ZBATIMIT³

Rregullat e së drejtës kontraktore kanë një fushë të gjërë të zbatimit. Mund të thuhet, me arsye, se çdo e drejtë në të kaluarën dhe në të drejtat e mëvonshme, si dhe në rregullat bashkëkohore me kujdes kanë zbatuar rregullat e së drejtës kontraktore për rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme pasurore midis pjesëmarrësve. Këto rregulla të së drejtës kontraktore kanë ndikuar shumë që bota të bëhet më komunikative, sepse ka ekzistuar dhe do të ekzistojë nevoja për rregullat e të së drejtës kontraktore .Këto rregulla janë të përshtatshme dhe fleksibile për një komunikim modern midis pjesëmarrësve në qarkullimin juridik.

Mund të thuhet pa kurrfarë dyshimi se rregullat e kontratës zbatohen gati në të gjitha degët e së drejtës. Përjashtim bëhet vetëm në të drejtën penale, ku këto rregulla në kuptimin klasik nuk vijnë në shprehje, edhe pse disa elemente të kontratës në këtë degë vijnë në shprehje, p.sh në rastet e garantimit të mbrojtjes nga liria.

Në lëmin e së drejtës së punës kontrata vjen në shprehje kur lidhen marrëdhënia e punës, si në rastin kur zbatohen rregullat individuale të kontratës së punës, ashtu edhe rregullat e kontratës kolektive të punës. Në të drejtën ndërkombëtare publike me anë të kontratës rregullohen marrëdhëniet midis shteteve ose ndërmjet shumë shteteve .Te e drejta ndërkombëtare private gjithashtu përdoren rregullat e kontratës për rregullimin e marrëdhënieve midis pjesëmarrësve në marrëdhënie me elemente të huaja. Në të drejtën tregtare rregullat e së drejtës kontraktore gjejnë zbatim të dukshëm në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve .⁴Kjo vlen sidomos kur kontratat janë të së drejtës së detyrimeve dhe kontratat që janë thjeshtë të së drejtës tregtare.

Kontrata në të drejtën e detyrimeve si dhe rregullat e saj shërbejnë si bazë për rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme në këtë degë të së drejtës.Mund të thuhet se rregullat e kontratës në këtë degë të së drejtës janë nivel më të lartë të zbatimit.

³ Dr Alajdin Alishani: E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 1989, fq 185

⁴ Dr Stojan Cigoj: Teorija obligacij, Ljubljana 1981 fq 93-94

I.3. TERMINOLOGJIA

Rreth emërimit të kontratës përdoren emra të ndryshëm në të gjitha drejtat nacionale. Pra, pos termit kontratë, përdoren edhe këto terma: marrëveshje, konventë, traktat, pakt, dakordim, hollim, aranzhman. Shprehja kontratë(contractus) është term që më së tepërmi përdoret për përcaktimin dhe emërtimin e këtij burimi të së drejtës së detyrimeve. Ajo nënkupton marrëveshje e dy ose më tepër personave që kanë për qëllim të krijojnë efekte të caktuara juridike. Personat që marrin pjesë në kontratë quhen palë kontraktuese, kontraktuesit, bashkëkontraktues. Secila palë përfaqëson anën e caktuar të kontratës si edhe interesin e caktuar. Në kontratë mund të jenë dy apo më tepër persona që kanë pozita të ndryshme. Madje, përdoret shprehja “marrëveshje”, që nënkupton çdo dakordim midis palëve kontraktuese për krijimin, ndryshimin ose shuarjen e një marrëdhënie të caktuar.⁵

I.4. RËNDËSIA E KONTRATËS

Kontrata ka rëndësi të madhe në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve si në drejtat nacionale ashtu edhe në rregullat e unifikuara. Me anë të saj organizohet qarkullimi i brendshëm ashtu edhe i jashtëm i mallrave dhe i dhënies së shërbimeve. Me anë të kësaj bartet pronësia, ndërsa në disa të drejta të tjera ajo shërben si bazë për kalimin e pronësisë. Parimisht kjo bartje bëhet me shpërblim meqë ka raste më të rralla kur bartja e pronësisë bëhet pa shpërblim.

Në të drejtën e detyrimeve dhe në të drejtën ekonomike si edhe në degë të tjera të së drejtës kontrata ka rëndësi të posaçme në qarkullimin juridik. Ky qarkullim është i kushtëzuar nga nevoja që ekziston për këtë mjet të spikatur qarkullim është i kushtëzuar nga nevoja që ekziston për këtë mjet të spikatur në qarkullim juridik. Me anë të kontratës ndihmohet që të krijohet një komunikim midis pjesëmarrësve të ndryshëm në realizimin e qëllimeve të tyre. Vlera më e madhe e rregullave të kontratës konsiston në faktin se ajo ka krijuar teorinë e përgjithshme të së drejtës kontraktore.

Kontrata duke u lidhur solo consensus ka përforcuar konstatimin se solo consensus obligat – thjesht vullneti obligon. Ky vullnet në të drejtën bashkëkohore shprehet në forma tëndryshme

⁵ Dr Alajdin Alishani: E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 1989, fq 187

.Në këtë mënyrë kontrata misionin që e ka kryen me sukses.Sa më me sukses e kryen këtë aq më tepër ngriten rregullat e së drejtës kontraktore dhe të kontratës në nivel edhe më të lartë në qarkullimin juridik, në sistemin juridik si dhe në rregullat e unifikuara.⁶

II. PARIMET E SË DREJTËS KONTRAKTORE

Parimet e së drejtës kontraktore janë liria e kontraktimit dhe parimi I konsensualizmit. Në qoftë se analizohet doktrina juridike e të drejtave nacionale, mund të vërehet se disa shkencëtarë I numërojnë këto dy parime të së drejtës kontraktore.

II.1 LIRIA E KONTRAKTIMIT

II.1.1 Kuptimi – Liria e kontraktimit është parimi i së drejtës kontraktore.Ajo përbëhet nga liria e vendosjes së palëve për lidhjen e kontraktës. Prandaj, çdo sistem juridik i jep kësaj vend me rëndësi në rastet ku vjen në shprehje aktiviteti individual.

Liria e kontraktimit në një formë ose tjetër ka ekzistuar edhe në të drejtat e kaluara, ekziston në të drejtat e mëvonshme dhe në të drejtën bashkëkohore. Kjo liri nuk ka qenë në formë të njejtë, sepse në të ndikojnë kushtet e ndryshme ekonomiko-shoqërore dhe niveli i superkulturës. Në rrugën e vet të zhvillimit ajo dikur ka qenë më pak në përdorim, ndërsa dikur përdorimi ka qenë normal, ose më tepër i theksuar. Është e vërtetë se në rrjedhat e këtij parimi ajo në mënyre absolute nuk është zbatuar kurrë meqenëse ekziston një nevojë e madhe e shoqërisë që veprimi individual të jetë shprehje e nivelit të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore dhe nevojave të vetë sistemit juridik.⁷

II.1.2 Anatomia e vullnetit – Anatomia e vullnetit në të kaluarën ka qenë nën ndikimin e fuqishëm të formalizimit.E themi këtë sepse ka ekzistuar parimi se forma përcakton esencën e gjërave - forma data esse rei.Kjo formë e ka kufizuar lirinë në pikëpamje të mënyrës së shprehjes së vullnetit, por nuk e ka kufizuar në pikëpamje të opcionit që të lidhet apo të mos lidhet

⁶ Dr Alajdin Alishani: E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 1989, fq 187

⁷ Dr Slobodan Perovic : Obligaciono Pravo, Beograd 1990, fq 152

kontrata. Vullneti i palëve është forcë obliguese dhe ai është mbi ligjin. Fuqia obliguese e kontratës krijohet në bazë të vullnetit të palëve e jo në bazë të ligjit. Ata theksojnë se kontrata është mbi ligjin - le contrat est superieure a la loi. Madje ata e kanë mbrojtur rregullën se kush thotë kontratë thotë drejtshmeri – qui dit de contrat dit juste. Kufijtë e kësaj lirie mund të jenë liria e tjetrit e jo mbrojtja e interesit të përgjithshëm. Sikundër mund të vërhet, autonomia e vullnetit është kuptuar shumë e gjërë, meqë kuptimi i këtillë u është përgjegjur filozofisë individualiste, ekonomisë liberale dhe kuptimit të pronësisë private.

II.1.2 Pasojat e mësimit të tillë – Kuptimi në këtë mënyrë i autonomisë së vullnetit në lëmin e së drejtës kontraktore ka krijuar pengesa të ndryshme rreth formës së kontratës, përmbajtjes dhe ekzekutimit të saj. Sipas mësimit të këtyre përfaqësuesve palët kontraktuese janë të lira të vendosin se në çfarë forme do të shprehin vullnetin e tyre. Sipas tyre përmbajtja e kontratës nga palët kontraktuese caktohet lirisht. Kjo përmbajtje është ligj për palët. Nëse në këtë ekziston ndonjë mungesë në vullnetin e palëve rreth caktimit të përmbajtjes së kontratës, atëherë ajo anulohet. Sa i përket përmbushjes së kontratës gjithashtu mirret se palët lirisht e kanë lidhur kontratën dhe lirisht edhe e përmbushin. Këtë ekzekutim duhet të bëjmë duke respektuar parimin paceta sunt servanda. Dhe në fund pasojat e këtij mësimi kanë qenë në interpretimin e kontratës sepse kanë kërkuar që në çdo rast të vërtetohet vullneti i përbashkët i tyre.⁸

II.1.3 Autonomia e vullnetit dhe dispozitat ligjore – Autonomia e vullnetit, ashtu sikundër është mësuar në doktrinën juridike, gjatë historisë së vet nuk është zbatuar në plotëkuptimin e fjalës.

II.1.4 Kritika e teorisë së autonomisë së vullnetit – Ashtu sikundër është kuptuar autonomia e vullnetit, jo vetëm që nuk është zbatuar, por edhe nuk i është përgjegjë njëmendësinë ekzsistuese në të drejtën kontraktore. Për këtë arsye në shek XIX dhe XX kritikohet mësimi i përfaqësuesve të kësaj teorie kritike evidente se vullneti i palëve nuk e ka rolin vendimtar dhe të vetëm te kontrata. Ky vullnet e ka vendin e vet, por në suazat e rregullave të drejtshmerisë (aequitas), ndershmerisë (bonne foi) dhe të sigurisë.

⁸ Dr Dimitar Pop Georgiev: Obligationo Pravo, Skopje 1986, fq 128-129

II.1.5 Kufizimi i lirisë së kontraktimit – Liria e kontraktimit si në të kaluarën ashtu edhe në të drejtën bashkëkohore nuk është zbatuar në mënyrë të pakufizuar. Kjo është normale, sepse asnjë e drejtë në rrjedhat e së drejtës bashkëkohore nuk mund të shfrytëzohet në mënyrë të pakufizuar, por ajo është e kufizuar në raste dhe situata të ndryshme. Këtë duhet marrë si normale, sepse qarkullimi i mallrave dhe dhënia e shërbimeve nuk mund të organizohet pa respektimin e rrjedhave të caktuara të ligjeve në fuqi dhe rrjedhave të caktuara të ekonomisë së tregut. Pos këtyre rasteve, liria e kontraktimit kufizohet edhe nga detyra e lidhjes së kontratës së caktuar, siç është kontrata mbi sigurimin, edhe me përmbajtjen e caktuar të saj siç është kontrata mbi shfrytëzimin e banesës. Madje, kjo liri është e kufizuar edhe për nga mundësia e zgjedhjes së palës kontraktuese. Këtë po e themi, sepse prodhuesit e bimëve industriale kanë obligim që këto prodhime t’ua japin përpunuesve të tyre p.sh duhanin, luledielli, panxharsheqerin. Madje kjo liri kufizohet kur lidhen kontrata formale, sepse vullneti i palëve duhet të shprehet në formën e paraprirë sipas ligjit. Te lidhja e kontratave kolektive gjithashtu kufizohet kjo liri, sepse subjektet jo vetëm që e kanë dhënë pëlqimin për lidhjen e saj duhet të rrespektojnë, por atë duhet ta rrespektojnë edhe anëtarët tjerë që nuk e kanë dhënë pëlqimin ose kanë qenë kundër lidhjes së kësaj kontrate, ose ndërkohë janë bërë anëtarët e rinj të kolektivit.

II.1.6 Përfundimi – Liria e kontraktimit është parim i së drejtës kontraktore. Ajo më së miri ka ardhur në shprehje në suazat e torisë së autonomisë së vullnetit. Përndryshe ose shprehimisht parashihet në dispozitat ligjore ose rrjedh nga këto dispozita. Ç’prej fillimit deri në të drejtën bashkëkohore ekziston edhe do të ekzistojë në të ardhmen.⁹

II.2 PARIMI I KONSENSUALIZMIT

⁹ Dr Dimitar Pop Georgiev: Obligaciono Pravo, Skopje 1986, fq 129

II.2.1 Kuptimi

Në të drejtën nacionale si dhe në rregullat e unifikuara parimi i konsensualizmit konsiderohet si parim i së drejtës kontraktore. Sipas tij do të thotë se kontrata mund të lidhet thjesht në bazë të vullnetit të palëve-solo consensus. Sipas këtij parimi disa kontrata në qarkullimin juridik mund të lidhen ose lidhen me vullnetin e palëve kontraktuese. Për krijimin e këtyre kontratave nuk nevojitet forma e caktuar. Palët kontraktuese duhet vetëm ta shprehin vullnetin e tyre me gojë, me shkrim, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë dhe pastaj konsiderohet se ajo është e lidhur. Me fjalë të tjera, palët duhet të këmbëjnë vullnetet e tyre, kurse ky vullnet duhet të rezultojë lidhjen e kontratës. Kontrata, në bazë të këtij parimi, duhet të lidhet duke marrë për bazë rregullat e parimit bona fides. Në kushte normale këtu vullneti thjesht obligon solo consensus obligat – dhe kjo rregull duhet të dominojë në ato kontrata ku zbatohen ose mund të zbatohen rregullat e këtij parimi. Sikundër mund të vërehet, rregullat e parimit të konsensualizmit mbështeten në vlerat morale, sepse disa kontrata në qarkullim mund të lidhen në bazë të besimit reciprok të palëve. Këtu vjen në shprehje niveli i rregullave të moralit, niveli i civilizimit juridik dhe më gjërë, vetëdija juridike e pjesëmarrësve në marrëdhëniet kontraktore.

Parimi i konsensualizmit është prezent në rregullat e unifikuara në të drejtat nacionale. Kjo presence është evidente por jo e pakufizuar. Kufizimi i rregullave të këtij parimi rrjedh nga zhvillimi i shoqërisë, zhvillimi moral i saj, zhvillimi i së drejtës dhe vetëdijes juridike të palëve kontraktuese dhe, kuptohet, edhe zhvillimi i marrëdhënieve ekonomike. Këtij parimi më së shumti i është kundërvënë parimi i formalizimit në marrëdhëniet kontraktore dhe të vetë zhvillimit të marrëdhënieve në treg.¹⁰

II.2.2 Zhvillimi i këtyre rregullave- Rregullat e parimit të konsensualizmit nuk kanë ekzistuar në të drejtat e vjetra ngase në ato të drejta nuk kanë ekzistuar kushtet e nevojshme për zhvillimin e tyre. Nga burimi e së drejtës romake dihet se kazuistika e saj këtë parim nuk e ka njohur¹¹

¹⁰ Dr Slobodan Perovic : Obligaciono Pravo, Beograd 1990, fq 182

¹¹ Dr Slobodan Perovic : Obligaciono Pravo, Beograd 1990, fq 182-189

III KUSHTET PËR LIDHJEN E KONTRATËS

Duke analizuar doktrinën juridike për kushtet për lidhjen e kontratës mund të thuhet se ekzistojnë dy grupe të caktuara. Në grupin e parë janë kushtet e përgjithshme për lidhjen e saj. Në grupin e parë janë kushtet e përgjithshme për lidhjen e saj¹². Në këtë grup hyjnë aftësia punuese e palëve, pajtimi i vullnetit të tyre, lënda e kontratës dhe baza e kontratës. Këto kushte janë të përgjithshme të cilat nevojiten për të gjitha kontratat, andaj edhe duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Pa plotësimin e këtyre kushteve nuk mund të bisedohet për atë se a është e lidhur kontrata e plotfuqishme.

Në grupin e dytë të kushteve për lidhjen e kontratës hyjnë edhe lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit, dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës dhe forma e kontratës.

III.1.1 Aftësia punuese e palëve - Aftësia punuese e palëve është kusht për lidhjen e kontratës. Sipas rregullave për lidhjen e kontratës së plotfuqishme është e nevojshme që kontraktuesi ta ketë aftësinë punuese, e cila kërkohet për lidhjen e asaj kontrate. Personi fizik në të drejtat nacionale fiton aftësinë punuese kur plotëson moshën madhore dhe kur i mituri lidh kurorë me lejen e organit gjegjë. Në këto dy raste konsiderohet se personi fizik ka aftësi punuese, andaj edhe konsiderohet se mund të merr veprime të ndryshme juridike. Aftësia e kufizuar punuese fitohet kur personi i caktuar plotëson moshën 14 vjeqare dhe kur personit madhor i mirret pjesërrisht aftësia punuese me vendim të organit kompetent. Personi fizik që ka mbushur moshën 15 vjeqare dhe është i punësuar, mund të disponojë me të ardhurat që I realizon nga kjo marrëdhënie, Të miturit që lidh kontratë pasi të ketë mbushur moshën 15 vjeqare i kërkohet leja e prindit (prindërve), kur ka të bëjë me kontratë që esenialisht mund të ndikojë për jetën e tij. Sa u perket punëve të përditshme, të miturit kanë të drejtë të lidhin kontrata pa pëlqimin e prindërve të tyre, p.sh blerja e gjërave të përditshme.¹³

Madje, personat me aftësi të kufizuara punuese, të cilët nuk janë të punësuar, mund të lidhin ndonjë marrëdhënie juridike nëqoftëse ekziston leja e përfaqësuesit ligjor. Pa këtë leje personi me aftësi të kufizuar punuese mund të lidhë punë juridike që kanë të bëjnë me zotërimin me të

¹² Guy Lambert: Cours droit civil, Paris, 1971 fq 18

¹³ Lambert: Cours droit civil, Paris, 1971 fq 21

ardhurat nga marrëdhënia e punës. Ndërkaq, personat madhore të cilëve u është kufizuar pjesërisht aftësia punuese, mund të krijojnë marrëdhëniet juridike vetëm me lejen e organit që ka kufizuar aftësinë punuese të tij.

Edhe personat juridik duhet të kenë aftësi punuese në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve. Personi juridik ka aftësi juridike mirëpo ka aftësi edhe punuese. Aftësia e parë ose juridike vjen ose varet si pasojë e aftësisë së personit ose organit të tij që shpreh vullnetin e vet. Kur ky person fizik ose organi juridik i personit fiton cilësinë e këtij personi vetëm atëher mund të themi se ka aftësi juridike.

Personi juridik mund të ketë paaftësi afariste të plotë ose të kufizuar. Paaftësia punuese ekziston kur është e nevojshme që të jipet pëlqimi nga shumë organe të personit juridik kurse nga ana tjetër nëse këtë nuk e kanë bërë me shprehje të vullnetit, atëherë kemi paaftësinë punuese. Kurse paaftësia është kufizuar punuese ekziston kur disa organe të personit juridik janë të autorizuar që të japin pëlqimin më vonë ose kur pëlqimin duhet ta jep ndonjë organ jashtë personit juridik.

III.1.2 Pajtimi i vullnetit të palëve - Pajtimi i vullnetit të palëve është kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës. Kur analizohet doktrina juridike rreth mbarështimit të këtij kushti mund të vërehet se disa shkencëtarë këtë kusht e prezantojnë me anë të ofertës dhe të pranimit të saj, ose atë e përziejnë me ofertën dhe pranimin e saj. Ne mendojmë se pajtimi i vullnetit të palëve si kusht për lidhjen e kontratës duhet të analizohet veçmas, sepse ka veçoritë e veta që deri diku dallojnë nga oferta dhe pranimi i saj. Si duket kështu duhet vepruar ngase me anë të ofertës dhe pranimit të saj mund të lidhet kontrata, duke marrë parasysh këto dy veprime ose elemente të vullnetit të tyre. Kurse vetë vullneti dhe pajtimi i tij ka veçoritë e veta dhe është një prej kushteve për lidhjen e kontratës. Grupi tjetër i shkencëtarëve në të drejtat nacionale veçmas i analizojnë rregullat e këtij kushti dhe madje menjëherë shtrojnë rregullat për ofertën dhe pranimin e ofertës, sepse edhe këtu kemi një lloj përputhje të vullnetit të palëve për lidhjen e kontratës. Pasi që oferta dhe pranimi i saj ka të bëjë me lidhjen e kontratës, ne do të veprojmë sikundër veprojnë shkencëtarët e grupit të dytë, sepse na duket se kushti për lidhjen e kontratës duhet të dallohet prej lidhjes së kontratës në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve. Pajtimi i vullnetit duhet të jetë i dyanshëm, sepse për t'u lidhë kontrata duhet të vijë deri të dakordimi i vullnetit të

tyre. Kur vullneti i tyre përputhet, atëherë thuhet se ka ardhur deri te pajtimi i vullnetit. Me fjalë të tjera, me këtë kontrata është lidhur, sepse janë plotësuar kushtet për lidhjen e saj.¹⁴

Me pajtimin e vullnetit të tëdy palëve krijohen të drejta dhe detyra. Andaj edhe thuhet se kontrata me të cilën krijohen të drejta dhe detyra dëshmon faktin se ajo është një angazhim intelektual i palëve, sepse ata duhet të dakordojnë vullnetet e veta. Duke qenë se ky pajtim i vullnetit është një dukuri psikologjike, atëherë kontratës i paraprijnë vendosja e palëve dhe vetëdija e tyre për lidhjen e saj. Vetëdija e palëve është aftësia fizike dhe mentale e tyre që me fuqinë e mendimit të tyre të krijojnë efektet e caktuara juridike midis tyre. Pajtimi i vullnetit të palëve duhet të ketë veti të caktuara. Pra ai duhet të jetë rrethanë relevante për lidhjen e kontratës. Vullneti i shprehur është serioz kur shpreh qëllimin e deklaruesit se dëshiron që të lidhë kontratën. Vullneti serioz vlerësohet nga ana e gjykatës në çdo rast konkret, duke u nisur nga standardet shoqërore, në sjelljen e njerëzve dhe që shprehin seriozitetin se dikush dëshiron të lidhë kontratë p.sh në qoftë se një lopë shitet për 1.000 euro supozohet se vullneti është serioz, ndërsa nëse një çantë prej lëkure shitet për 20 euro, atëherë konsiderohet se vullneti nuk është serioz. Vullneti i palëve është i vërtetë kur palët e kanë shprehur atë dhe ai me të vërtetë është i tyre. Në bazë të këtij vullneti kontrata lidhet dhe krijon efekte juridike p.sh lidhet kontrata e shitjes kur shitet një truall me sipërfaqe prej 2 ari me çmim prej 20.000 euro. Nga ana tjetër vullneti i palëve nuk është i vërtetë në rastet kur ajo është e simuluar për shkaqe të ndryshme, p.sh kur lidhet kontrata e shitjes me çmim fiktiv, kurse ndaras palët gojarisht caktojnë çmimin e vërtetë, me të vetmin qëllim që të paguajnë tatim më të ulët, ose kur lidhet kontrata mbi dhuratën si kontratë fiktive, kurse në të vërtetë lidhet kontratë e shitjes. Dhe në fund, kur vullneti i palëve është i mundshëm, do të thotë se lidhet kontrata për t'u realizuar qëllimi i mundshëm i palëve, p.sh blihet sendi që është në qarkullim, sendi që mund t'i bartet tjetrit, sendi që nuk është në kundërshtim me rregullat e moralit. Nga ana tjetër vullneti i palëve është i pamundshëm nëqoftëse lidhet kontrata për sendin që është jashtë qarkullimit p.sh bëhet ura e caktuar, liqeni i caktuar ose rruga e caktuar. Vullneti i pamundshëm është ai kur ai i kundërshtohet rregulave të moralit, p.sh shitja e femrës, marrja e të hollave humbëse për shkuesi, marrja e shpërblimit më të lartë sesa puna e bërë e ndërmjetësuesit të kontrata mbi ndërmjetësimin.¹⁵

¹⁴ Dr Branko Morait: Obligaciono pravo, knjiga. I, Banja Luka, 1997, fq 157

¹⁵ Dr Branko Morait: Obligaciono pravo, knjiga. I, Banja Luka, 1997, fq 157

III.1.3 Lënda e kontratës

Kuptimi: Lënda e kontratës është kusht i përgjithshëm për lidhjen e saj. Pa ekzistimin e këtij kushti nuk mund të flitet se kontrata është lidhur. Detyra që rrjedh nga kontrata është lënda saj. Mirëpo kontrata mund të krijojë disa detyra, prandaj ajo në këto raste mund të ketë shumë lëndë, p.sh lënda e kontratës së shitjes është dorëzimi i sendit dhe pagimi i çmimit, te kontrata mbi veprën lëndë është kryerja e punës së caktuar dhe pagimi i shpërblimit, te dhurata është lëndë dorëzimi i sendit dhuratëmarrësit te kontrata mbi qiranë lëndë është dorëzimi i sendit në shfrytëzim dhe pagimi qirasë. Lënda e kontratës mund të jetë sendi i luajtshëm ashtu edhe sendi i paluajtshëm si dhe sendi i konsumueshëm. Lënda e saj mund të jetë e drejta edhe atë si të drejtat reale ashtu edhe të drejtat e detyrimeve. Në të drejtën reale lënda e kontratës mund të jetë e drejta e pronësisë, e drejta e servitudit real, e drejta e servitudit, e drejta e hipotekës, e drejta e pengut etj. Në të drejtën e detyrimeve lënda e kontratës mund të jetë çdo e drejtë që mund të bartet.

Vetitë e lëndës: Lënda e kontratës për të pasur efektet e veta juridike duhet të ketë cilësi të caktuara. Në të drejtat nacionale si dhe në rregullat e unifikuara dhe kjo është rregull tradicionale e cila ka ekzistuar dhe ekziston edhe sot. Sipas këtyre rregullave lënda e kontratës duhet të jetë e mundshme, e caktuar ose e caktueshme si dhe të jetë e lejuar.¹⁶ Këto veti të lëndës së kontratës duhet kumulativisht të plotësohen, sepse pa këto veti lënda e saj nuk mund të krijojë efekte juridike. Parimisht lënda e kontratës ka ndonjë vlerë të caktuar dhe për këtë ekziston interesi legjitim i palës kontraktuese ose i vetë palëve. Ky interes në këto marrëdhënie zakonisht është me karakter pasuror. Këtë konstatim duhet marrë si konstatim parimor, sepse çdo lëndë e kontratës mund të vlerësohet në të holla, mirëpo ka raste kur lënda e kontratës nuk ka karakter pasuror, por është e mjaftueshme që të konsiderohet si lëndë e saj.

III.1.3.1 Lënda duhet të jetë e mundshme- Një nga kushtet e nevojshme për vlershmërinë e saj është se lënda duhet të jetë e mundshme. Lënda është e mundshme nëse mund të ekzekutohet. Pamundësia e lëndës së kontratës mund të jetë objektive, subjektive, pamundësia juridike, fizike, fillestare, e mëvonshme.

¹⁶ Dr Stojan Cigoj: Teorija obligacij, Ljubljana 1981 fq 112-114

III.1.3.2 Lënda e kontratës duhej të jetë e caktuar ose e caktueshme – Lënda është e caktuar kur që në momentin e lidhjes së kontratës ajo ekziston. Ajo duhet të ekzistojë pa kurrfarë ndryshimi, sepse edhe fizikisht ose me ndonjë dëshmi tjetër prezenton ekzistimin e saj, p.sh blihet zagari për gjueti, shtëpia e caktuar që gjindet në rrugën dhe në vendin e caktuar me sipërfaqe të caktuar. Kur është fjala për bartjen e sendit të luajtshëm zakonisht ai i prezentohet palës së caktuar dhe është individualisht i caktuar. Kur ka të bëjë me sendin e paluajtshëm medoemos ai duhet të jetë gjithashtu individualisht i caktuar.

III.1.3.3 Lënda e kontratës duhet të jetë e lejuar – Themë se lënda e kontratës është e lejuar në qoftë se është në pajtim me rregullat e së drejtës kontraktore ose me rregullat e vetë sistemit juridik. Rëndësia kryesore e lëndës së kontratës konsiston në faktin se mundëson që të krijohen kushtet për lidhjen e saj. Mund të thuhet se lënda e kontratës hyn në rradhën e kushteve më me rëndësi të saj, sepse lënda është ajo që ndikon dhe influencon që pala e interesuar të lidhë kontratën. Nga ana tjetër duhet cekur se për të pasur një rrjedhë normale kontrata lënda e saj duhet së paku të jetë në përputhje me rregullat e sistemit juridik.

III.1.4 Baza e kontratës

III.1.4.1 Kuptimi: Baza e kontratës është kusht esencial dhe i përgjithshëm për lidhjen e çdo kontrate. Prandaj, në marrëdhëniet kontraktore kërkohet që çdo kontratë të ketë bazën e vet, sepse pa bazë nuk mund të flitet për ekzistimin e saj. Ajo është kusht i domosdoshëm për çdo kontratë – le contrat droit avoir une cause. Baza e saj shpjegon se dikush obligohet – cur debetur, ose shpjegon sepse krijohet detyrimi – causa finalis.

Baza e kontratës është konstante, e pandryshueshme në kontratat e llojit të njëjtë dhe është pjesë përbërëse e saj. Ajo duhet të ekzistojë në çdo kontratë në momentin e lidhjes së saj. Baza është kategori juridike, objektive, meqë ajo mund të shqyrtohet dhe të studiohet edhe në aspektin psikologjik, filozofik, sociologjik dhe ekonomik. Ajo gjithnjë duhet t'u bëhet e ditur palëve kontraktuese, meqenëse mund t'u është e panjohur personave të tretë.¹⁷

III.1.4.2 Mendime rreth bazës së kontratës: Doktrina juridike në të drejtat e ndryshme nacionale rreth kuptimit të bazës nuk ka krijuar ndonjë qëndrim unik. Mirëpo, duke studiuar rrjedhat e bazës së kontratës janë krijuar mendime, ide të ndryshme rreth kuptimit të saj. Këto ide

¹⁷ Dr Jozef Salma – Obligaciono pravo, Novi Sad, 1999, fq 152

jo vetëm që kanë krijuar teori të ndryshme rreth bazës sëkontratës , por kanë zhvilluar ide të ndryshme në të drejtën kontraktore dhe kanë zhvilluar shumë çështje të së drejtës kontraktore.

III.1.4.3 Baza në disa kontrata:Baza e kontratës ekziston në çdo kontratë. Sipas rregullave të së drejtës kontraktore baza përpos që duhet të ekzistojë në çdo kontratë, ajo është e përhershme dhe e përgjithshme për kontraktat.Mirëpo, ajo dallohet nga kontrata në kontratë. Kështu, te kontrata e shitjes baza e detyrës së blerësit për t’ia paguar çmimin shitësit konsiston në faktin se shitësi është i obliguar ta dorëzojë sendin në pronësi të blerësit. Pra me këtë ai do të bëhet pronari i atij sendi.Ky përcaktim i bazës është sipas teorisë klasike, kurse sipas teorisë neoklasike që e ka mbrojtur prof Dr Henri Capitan, blerësi obligohet ta paguajë çmimin për arsye të ekzekutimit të detyrës së shitësit. ¹⁸Siç mund të vërehet, sipas teorisë klasike ashtu edhe neoklasike gati se në mënyrë të njëjtë shpjegohet baza e kontratës në kontratat e dyanshme detyruese e themi sepse sipas teorisë klasike thuhet: ‘’ baza e detyrës së njërës palë shërben si bazë e detyrës së palës tjetër’’ , kurse sipas teorisë neoklasike: ‘’ baza e detyrës së njërës pale është bazë e ekzekutimit të detyrës së palës tjetër’’. Pra këtu, në të dy rastet kemi detyra të paleve dhe këto detyra janë reciproke.

¹⁸ Dr Jozef Salma – Obligaciono pravo, Novi Sad, 1999, fq 153

III.1.4.4 Rëndësia e bazës së kontratës:

Rëndësia e bazës së kontratës më së shumti shihet në rastet konkrete të marrëdhënieve kontraktore. Duke analizuar rrastet e ndryshme në praktikë kihet përshtypje se ky kusht për lidhjen e kontraktës ka një zbatim të mirëfilltë dhe transparent. Kjo mund të thuhet edhe për rregullativën rreth bazës së kontratës, sepse parashihen dispozitat që janë racionale, të mundshme dhe të nevojshme.

III.1.4.4.1 Mungesa e bazës së kontratës-Është rregull që çdo kontratë të ketë bazën e vet. Në praktikën gjyqësore ndodh që baza të mos ekzistojë në kontratat e dyanshme detyruese. Këtë e kemi te kontrata e shitjes ku thuhet se detyra e blerësit është e pabazë në qoftë se sendi individualisht i caktuar zhduket nga fuqia madhore pa fajin e dikujt, ose detyra e shitësit është e pabazë kur në këtë kontratë çmimi seriozisht nuk është caktuar, ose te kontrata mbi huan mirret se baza mungon në detyrimin e huamarrësit, në qoftë se obligohet që ta kthejë sasinë e caktuar të të hollave që fare nuk i ka marrë. Mungesa e bazës së kontratës mund të shkaktohet në momentin e lidhjes së kontratës. P.sh zhduket lënda e kontratës që është individualisht e caktuar ose pas lidhjes së kontratës anulohet kontrata, anulohet testamenti për shkaqet e parashikuara me ligj, zgjidhet kontrata për mosekzekutimin, mbajtja e prestimit nga kjo kontratë është e pabazë, pra të gjitha këto raste subjektet që kanë marrë diçka sipas këtyre bazave, duhet të kthejnë ç’kanë marrë, sepse me këtë rast mungon baza e ndaljes së prestimit.

III.1.4.4.2 Baza është fiktive – Baza e kontratës është fiktive kur palët kontraktuese me qëllim fshehin bazën e vërtetë ndaj personave të tretë. Kështu ndodh kur palët lidhin kontratë me qëllim të shmangies së pagimit të tatimit , të mos përmbushjes së detyrimit ose të mosdhënies së alimentacionit. Në këto raste mund të lidhet edhe kontrata e simuluar ku opinionit i tregohet se kanë lidhur kontratën për shërbimin ose për dhuratën, ndërsa në të vërtetë kanë lidhur kontratën e shitjes. Këto raste janë edhe në praktikën gjyqësore, kur lidhen kontrata për qarkullimin e paluajtshmërisë.¹⁹

¹⁹ Dr Alajdin Alishani, vepra e njejtë, fq.226

III.1.4.4.3 Baza e ndaluar – Baza e kontratës mund të jetë e ndaluar. Në praktikë konsiderohet se baza e kontratës është e ndaluar me të cilën huadhënësi kontrakton për vete të drejtën që në rast se huamarrësi nuk e kthen sendin e llojit dhe të cilësisë së njëjtë, prej tij mund të kërkojë në vend të kthimit të sendit pagimin e shumës së të hollave e cila tejkalon vlerën në qarkullim të atij sendi.

III.1.4.4.4 Pasojat juridike të mungesave të bazës së kontratës:

Në qoftë se ndodh që baza e kontratës mungon, është fiktive ose është e ndaluar, atëherë themi se kontrata është e pavlershme. Pavlershmëria në këtë rast mund të jetë absolute, sepse në shumicën e rasteve kontrata cenon interesin e përgjithshëm. Me fjalë të tjera kur vërtetohen këto raste, ose rastet kur baza është në kundërshtim me rregullat imperative, me rregullat e rendit juridik, me rregullat e dokeve të mira dhe me rregullat e moralit, atëherë mund të shtrohet pyetja kur baza e kontratës i ka këto të meta se a mund të jetë me pavlefshmëri relative. Parimisht duhet thënë se mundet, sepse kjo çështje vlerësohet nga fakti se çka është cenuar me bazën e ndaluar, me bazën fiktive ose kur baza mungon.²⁰

III.1.4.4.5 Motivimi i kontratës:

Kuptimi - Motivimi i kontratës nuk është kusht për lidhjen e saj. Ai është jashtë kontratës sepse paraqet, qëllimin e tërthortë për lidhjen e saj ose për krijimin e detyrimit. Motivimi i kontratës nënkupton faktorin e rëndësishëm psikologjik i cili te pala kontraktuese shpreh dëshirën dhe shtyn palën për të marrë vendim për lidhjen e kontratës.

Dallimet midis rregullave të bazës dhe motivit të kontratës – Nga kjo që u tha deri me tani rrjedh se baza dhe motivi i kontratës kanë dallime të dukshme. Baza e kontratës është kusht i përgjithshëm për lidhjen e çdo kontrate, ndërsa motivi nuk është. Baza është kusht i përgjithshëm dhe i domosdoshëm për lidhjen e çdo kontrate, ndërsa motivi nuk është i domosdoshëm të ekzistojë në çdo kontratë.

²⁰ Dr Alajdin Alishani, vepra e njejtë, fq.228

III.2 KUSHTET E VEÇANTA PËR LIDHJEN E KONTRATËS.

Për disa kontrata në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve pos që duhet të plotësohen kushtet e përgjithshme, duhet të plotësohen edhe kushtet e veçanta për krijimin e tyre. Këto raste janë: lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit, lidhja e kontratës ku kërkohet dhënia e pëlqimit dhe forma e kontratës. Kuptohet, këto kushte mirren parasysh jokumulativisht, por çdonjëra prej tyre në rastet e caktuara mund të mirret parasysh ose duhet të mirret parasysh. Secila nga këto kushte në rast nevojë duhet t'u bashkangjitet kushteve të përgjithshme siç janë aftësia punuese e palëve, pajtimi i vullnetit, lënda dhe baza e kontratës. Kur ndonjëra prej kushteve të veçanta kërkohet, ajo duhet edhe të plotësohet, sepse në të kundërtën kontrata nuk mund të krijohet. Këtu duhet thënë se kushti i veçantë siç është lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit ka humbur bukur shumë nga aktualiteti, sepse kontratat reale tani konsiderohen si kontrata konsensuale. Por duhet thënë se ka disa raste që dorëzimi i sendit ende konsiderohet si kusht i veçantë për lidhjen e kontratës.²¹

1. Lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit – Në të drejtën e detyrimeve disa kontrata konsiderohen se janë të lidhura kur janë të plotësuar kushtet e përgjithshme dhe kur është bërë dorëzimi i sendit. Kështu ndodh kur lidhet kontrata mbi huan, depozitin, huapërdorjen, dhuratën, transportimin e sendeve dhe kaparin.
2. Dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës – Në të drejtën e detyrimeve, gjegjësisht në të drejtën kontraktore, për disa kontrata duhet të jipet pëlqimi për lidhjen e tyre.
3. Dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës nga një person i tretë – Në të drejtat nacionale parashihet nevoja e dhënies së pëlqimit për lidhjen e kontratës nga ana e personit të tretë

²¹ Alex Éeill: Droitcivil, Les obligations, Paris, 1971 fq. 295-296

III.3 FORMA E KONTRATËS

A) Kuptimi – Forma e kontratës është kusht i veçantë për lidhjen e disa kontratave në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve.

B) Llojet e formës – Të drejtat nacionale dallojnë disa lloje të formës së kontratës:

1. Forma me shkrim të kontratës -
2. Forma e dokumentit publik
3. Forma ad solemiatem – forma solemne e kontratës
4. Forma ad probationem – forma provuese e kontratës
5. Forma ligjore
6. Forma kontraktore
7. Dallimi i rregullave të kontratave formale nga formalitetet tjera në qarkullim
8. Konvalidim i kontratës
9. Sanksionimi i mungesës së formës së kontratës
10. Zgjidhje e kontratës formale
11. Rëndësia e kontratave formale²²

²² Dr Alajdin Alishani – vep e njejtë fq.239

IV. Sfondi i evoluimit historiko-ligjor i së drejtës së konsumatorit dhe kontratave konsumatore. E drejta e konsumatorit si multidisiplinë juridike.

IV.1 Sfondi historik i evoluimit të së drejtës së konsumatorit dhe kontratatve konsumatore.

Marrëdhënia juridike e krijuar midis konsumatorit dhe prodhuesve, furnizuesve apo shitësve është në disekuilibër. Ky disekuilibër formohet për arsye se, kompeteca, informacioni që tregtarët disponojnë dhe fuqia e tyre financiare, i'u krijojnë mundësitë t'i diktojnë konsumatorit vendimet e marra prej tyre. Ky disekuilibër ka ekzistuar gjithmonë. Në të drejtën romake ekzistonin rregulla të ndryshme, të cilat tentonin të krijonin mbrojtje për blerësin kundrejt shitësit mashtrues. Zhvillimi i ekonomisë në shekullin e XIX dhe të XX krijoi bindjen se konsumatori ishte kthyer në mbretin e sistemit ekonomik. Në krijimin e këtij besimi ndikoi konkurrenca e lirë midis ndërmarrjeve, e cila në parim duhet të shumëfishonte llojshmërinë e mallrave, të rriste cilësinë e tyre, e më pas uljen e çmimit. Mirëpo ky postulat ishte larg realitetit me të cilin përballeshin konsumatorët, në jetën e përditshme. Ishin fillimet e viteve '60 që shfaqën si probleme shoqërore shqetësimet e konsumatorit. Kësaj periudhe kohore i korrespondon një zhvillim ekonomik i paperçedent, i cili solli shumëllojshmëri në mallra dhe në shërbime. Ndikuan në përforcimin e pozitës së tregtarëve, duke dobësuar në vazhdimësi pozicionin e konsumatorëve, rritja e përmasave të ndërmarrjeve, kompleksiteti gjithnjë e më i madhi mallrave dhe shërbimeve, zhvillimi i kreditimit, i reklamave dhe marketingut . Të gjitha këto, rrisnin rrezikun që konsumatori të kthehej në një lodër, e cila mund të manipulohej shumë thjesht nga dora e specialistëve të marketingut. Në sistemin e ekonomisë së tregut, konsumatori trajtohet njëkohësisht si mbreti dhe si skllavi i sistemit të konsumimit që karakterizon shoqëritë e zhvilluara. Situata shfaqet veçanërisht e rëndë për konsumatorin, që është i defavorizuar për shkak të varfërisë, mungesës së informacionit apo moshës së tij.²³ Lindi nevoja për mbrojtjen e konsumatorit, jo vetëm ndaj tregtarëve mashtrues, si një drejtë e garantuar prej shumë kohësh, por mbi të gjitha garantimin për mbrojtje kundër abuzimit me pushtetin ekonomik. Abuzimi me pushtetin ekonomik nga ana e tregtarëve është fenomen i pandashëm në sistemin ekonomik që ne

²³Jean Calais-Auloy dhe Frank Steinmetz në "Droit de la consommation", DALLOZ, Botimi VI, faqe 1.

përfjetojmë dhe qëjo gjithnjëëshhtë i perceptueshëm nga opinion publik. Ishte Presidenti Kenedy, i cili në vitin 1962, konstatoi se konsumatorët përfaqësonin grupin ekonomik më të rëndësishëm në shoqëri dhe njëkohësisht më pak të dëgjuarin. Ai sugjeroi miratimin e një legjislacioni, i cili do të siguronte ushtrimin e plotë të të drejtave të konsumatorëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për herë të parë, konsumatorët filluan të grupohen e të organizohen për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre, fenomen i cili më pas u quajt “konsumatorizëm”. Disa vite më vonë, edhe vendet e Evropës Peëndimore u ndërgjegjësuën për rreziqet që i kanosen konsumatorit. Sot, politika komunitare për mbrojtjen e konsumatorit, është mjaft e konsoliduar dhe e garantuar nga instrumenta ligjorë apo struktura përkatëse të Bashkimit European. Tentativat europiane për mbrojtjen e konsumatorëve filluan me “Programin Paraprak për Informimin e Konsumatorëve”. Këshilli miratoi përfundimisht orientimet e ardhshme të politikës së Komunitetit Evropian për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve objektiva, të cilat u përcaktuan në Rezolutën e Këshillit të datës 09.11.1989. Politika e mbrojtjes së konsumatorit u inkorporua me anë të Traktatit të Maastricht në Traktatin e CE.¹⁰ Kështu lindi, natyrshëm me kalimin e kohës, një disiplinë e re juridike, ajo e së drejtës së konsumatorit²⁴

Me kalimin e kohës dhe zbatimin e këtij ligji në praktikë, u vunë re disa mangësi, të tilla si: Mosparashikimi i sanksioneve administrative, mostrajtimi në të i shërbimeve me interes të përgjithshëm, etj.

IV.2 Koncepte të përgjithshme mbi kontratat dhe të drejtën e konsumatorit.

Ekzistenca e së drejtës së konsumatorit bazohet në një konstatim të trefishtë: - Konsumatorët janë në pozicion më të dobët përballë tregtarëve; - Ligji ka për funksion të mbrojtë të dobët kundër të fortit; - E drejta civile klasike është e pamjaftueshme të sigurojë mbrojtje për konsumatorët. Thelbi i së drejtës së konsumatorit përbëhet nga rregulla, të cilat në mënyrë kumulative u përgjigjen dy kritereve:

1. Zbatimi i tyre ka efekt ndaj marrëdhënieve juridike të vendosura midis konsumatorëve dhe tregtarëve.

2. Qëllimi i tyre është të mbrojnë konsumatorin. Ky është koncepti më i ngushtë që ekziston për të drejtën e konsumatorit, kuptim i cili përmbledhet vetëm në këto dy kritere. Për të kuptuar më

²⁴ Charles Gide në “Cours d’économie politique”. Sirey, 1909, faqe 719.

mirë se ç'është e drejta e konsumatorit duhet të trajtojmë edhe konceptin e saj më të gjerë, i cili është i nevojshëm për të paraqitur tërësinë e fushës së zbatimit të së drejtës së konsumatorit.²⁵ Që një rregull të bëjë pjesë në të drejtën e konsumatorit mjafton që ai të zbatohet kryesisht për marrëdhëniet midis konsumatorëve dhe tregtarëve dhe nuk është e nevojshme që ai të zbatohet ekskluzivisht për këto marrëdhënie. Është e vështirë të përcaktohen përfundimisht se cilat janë rregullat juridike që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorit. Marrëdhëniet juridike të krijuara midis konsumatorëve dhe tregtarëve ndonjëherë i japin mundësinë për zbatim edhe rregullave që nuk kanë qëllim konsumatorist, por atom und të kenë një efekt pozitiv ose negative mbi konsumatorin.

IV.3 E drejta e konsumatorit si multidisiplinë dhe raporti i saj me degët e tjera të së drejtës.

Klasifikimi i disiplinave juridike, më parë bëhej mbi bazën e natyrës së normave përbërëse të tyre. Sot ky klasifikim tradicional është mbivendosur nga një tjetër klasifikim, bazuar në funksionin e normës juridike, ku bën pjesë edhe e drejta e konsumatorit. Klasifikimi i dytë është një kryqëzim i klasifikimit të parë, në këtë kuptim mund të flasim për pluridisiplinaritet të së drejtës së konsumatorit. E drejta administrative: Kontribuon në të drejtën e konsumatorit nëdy mënyra nga njëra anë, janë strukturat administrative të parashikuara në Ligjin “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” që kanë kryesisht për detyrë të kontrollojnë zbatimin e rregullave mbrojtëse të konsumatorit. Nga ana tjetër disa shërbime publike si postat dhe spitalet kanë të njëjtin raport me përdoruesit e tyre, siç kane tregtarët me konsumatorët. E drejta penale: Zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e konsumatorit, pasi disa detyrime të imponuara tregtarëve, nga Ligji “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve, janë të pajisura me sanksione penale. E drejta penale i jep një mbrojtje të dyfishtë konsumatorit pasi pa sanksionet penale, mbrojtja juridike nuk do të ishte një mbrojtje efektive. E drejta e konkurrencës: Rregullon raportet e ndërmarrjeve me njëra-tjetrën. Në kufinj të dy disiplinave ekzistojnë një tërësi rregullash që u përkasin të dyjave, siç është ndalimi i metodave tregtare aggressive. Në përgjithësi, rregullat e së drejtës së konkurrencës kanë gjithnjë ndikim te konsumatorët. Reciprokisht rregullat e së drejtës së konsumatorit ushtrojnë shpesh një influencë mbi konkurrencën.²⁶

²⁵ Jean Jean Calais-Auloy dhe Frank Steinmetz në “Droit de la consommation”, DALLOZ, Botimi VI, faqe 14

²⁶ Jean Jean Calais-Auloy dhe Frank Steinmetz në “Droit de la consommation”, DALLOZ, Botimi VI, faqe 21,

IV.3.1 Subjektet e së drejtës së konsumatorit

E drejta e konsumatorit kërkon të vendosë në ekuilibër marrëdhëniet që krijohen midis konsumatorëve dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve e ofruesve të shërbimeve. Ajo përcakton të drejtat e konsumatorëve, të cilat në të njëjtën kohë përbëjnë detyrime në ngarkim të tregtarëve. Tregtarët dhe konsumatorët janë subjektet e së drejtës së konsumatorit. Përcaktimi i këtyre dy kategorive na lejon të kuptojmë filozofinë e lëndës dhe të gjurmojmë se deri ku shtrihen kufizimet e saj, pra në cilat raste gjen zbatim Ligji “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”

IV.4 Konsumatori

Legjislacioni ne fuqi kujdeset për të përkufizuar kuptimin që ka termi ‘konsumator’, në mënyrë të tillë që përdoruesit dhe zbatuesit e tij, të dallojnë dhe të jenë të qartë se cila është kategoria e personave që gëzojnë mbrojtjen e posaçme të garantuar në këtë ligj.

“Konsumator” është çdo person fizik, i cili blen ose përdor mallra a shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose me ushtrimin e profesionit. Në kuptim të këtij ligji, si konsumatorë janë edhe organizatat jofitimprurëse.” Ky përkufizim përbëhet nga tre elemente, të cilët qëndrojnë ngushtësisht të lidhur midis tyre.

1. Çdo person fizik dhe çdo organizatë jofitimprurëse që blen ose përdor;

2. Mallra ose shërbime;

3. Për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose me ushtrimin e profesionit.

Elementi i parë: Janëdy kategori të konsumatorëve, ata që blejnë mallra a shërbime dhe ata që i përdorin ato. Për kategorinë e parë, mallrat ose shërbimet prodhohen, furnizohen, ofrohen apo shiten nga tregtarët mbi bazën e të ashtuquajturave kontrata konsumatore, si: kontrata e shitjes, kontrata e qerasë së sendeve, qerasë së veprave, kontrata e huapërdorjes etj. Duhet theksuar se rregullat mbrojtëse të së drejtës së konsumatorit zbatohen jo vetëm për kontratën e lidhur midis konsumatorit dhe tregtarit por edhe për fazën paraprake të saj. Ky evidentim ka një rëndësi konceptuale të cilën do ta trajtojmë në vazhdimësi. Kategoria e dytë e konsumatorëve janë ata të cilët përdorin mallrat ose shërbimet. Konsumatori që konsumon është shpesh dhe ai që përdor mallrat apo shërbimet, por nuk është gjithnjë e njëjta gjë. Një mall i blerë nga një person fizik mund të përdoret në disa raste edhe nga anëtarët e familjes së tij, të cilët janë palë e tretë në

kontratën konsumatore. Këta janë me cilësinë e personave të tretë në kontratë, por duke qenë përdorues të sendit të blerë, ata janë jashtë kufinjve mbrojtës të së drejtës civile. Kësaj kategorie i garantohet mbrojtje, bazuar në Ligjin “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” Konsumatori, është një të shumtën e rasteve një person fizik. Përdorimi i mallrave dhe i shërbimeve për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose me ushtrimin e profesionit, supozon në fakt përdorimin për plotësimin e nevojave vetjake, për të cilat mund të flasim vetëm duke iu referuar personave fizikë. Është kjo arsyeja për të cilën mbrojtja e së drejtës së konsumatorit në disa tekste ligjore të disa shteteve iu referohet vetëm personave fizikë.

Tre janë kategoritë e personave juridikë, që përfitojnë mbrojtje të njëjtë me konsumatorët. Ato janë shoqatat, fondacionet dhe qendrat, të cilat ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut, për realizimin dhe përmbushjen e të cilave ushtrojnë vetëm veprimtari jofitimprurëse. Kjo e fundit mund të jetë me karakter ekonomik ose joekonomik.

Elementi i dytë: Përdorimi i termave mallra dhe shërbime, tregon se nocioni konsumator mbulon një gamë të gjerë rastesh dhe zbatohet në situatë nga më të ndryshmet. “Mall” është çdo send i luajtshëm, i matshëm, i përcaktuar për t’u tjetërsuar ose përdorur prej konsumatorëve.” Çdo send, që plotëson këto cilësi të përcaktuara, mund të jetë object i konsumimit, që nga moment që ai blehet apo përdoret për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare apo me ushtrimin e profesionit. Ky term nuk duhet të reduktohet vetëm në sendet e konsumueshme, të cilat shkatërrohen me një përdorim siç janë produktet ushqimore, por ai përfshin edhe sendet e pakonsumueshme për nga natyra fizike e sendit.

Elementi i tretë: Ky element është një ktiter thelbësor, pasi është konsumator ai që blen dhe përdor mallra apo shërbime në funksion të nevojave vetjake, për plotësimin e tyre dhe për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare apo me ushtrimin e profesionit. Në këtë mënyrë arrijmë në përfundim se termi konsumator përcaktohet me të kundërtën e termit tregtar, pasi ndryshe nga ai, konsumatori nuk i përdor mallrat apo shërbimet për qëllime fitimi. Rëndësia e këtij elementi qëndron se me anë të tij bëhen të dallueshme se në cilat raste gjejmë zbatim rregullat mbrojtëse të së drejtës së konsumatorit. Në ligje specifike, të cilat gjithashtu kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, hasim përkufizime për temin konsumator, në qëllim të mbrojtjes së posaçme të garantuar nga to. Në të drejtën e konsumatorit ekziston një prezumim ligjor: ndodhja e konsumatorit në pozitë më të dobët në krahasim me tregtarët, edhe

pse në disa raste, konsumatori mund të jetë qytetar mbi nivelin mesatar i informuar. Në jetën e përditshme të gjithë, tregtarë ose jo, jemi konsumatorë. çdo person fizik ka në shumë raste të ekzistencës së tij, praktikisht çdo ditë cilësinë e konsumatorit edhe pse aim und të ushtrojë një aktivitet tregtar. I njëjti person mundet për një veprim juridik të ketë cilësinë e tregtarit dhe për një tjetër cilësinë e konsumatorit, kjo shfaqje e dyfishtë nuk është absurde pasi i njëjti person sipas veprimit që ka kryer mund të jetë në pozicionin e pushtetit, sic mund të jetë në pozicionin e më të dobët. Qëllimi i veprimit të kryer, për përdorim vetjak ose familjar, shërben si kriter për të përcaktuar cilësinë e konsumatorit ose të tregtarit.

IV.5 Tregtarët

Ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, jep përkufizim se cilët persona do të konsiderohet se gëzojnë cilësitë e subjektit të marrëdhënies konsumatore, që nuk janë konsumatorë, por që janë përballë tyre, pra tregtarët. Prodhues, shitës, furnizues apo ofrues të shërbimeve mund të jenë si personat fizikë ashtu edhe personat juridikë, të cilët veprojnë në kuadër të një aktiviteti të zakonshëm ekonomik që përfshin organizimin e prodhimit shpërndarjen dhe prezantimin e mallit apo të shërbimit. Mund t’i referohemi Ligjit “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar”, i cili jep përkufizimin e termit tregtar.

“Tregtarë” konsiderohen personat fizikë dhe shoqëritë tregtare, që gjatë ushtrimit të profesionit kryejnë veprime tregtare në emër të tyre. Ky ligj përcakton veprimet të cilat konsiderohen veçanërisht veprime tregtare. Termi tregtar në të drejtën e konsumatorit ka një kuptim të gjerë, është e mjaftueshme, që një ose disa persona të hyjnë në marrëdhënie juridike me konsumatorin, që të konsiderohen tregtarë. E drejta e konsumatorit zbatohet në mënyrë të njëjtë dhe pa dallime, si për shoqëritë e mëdha apo të vogla tregtare, pra për personat juridikë, ashtu dhe për personat fizikë tregtarë. Tregtarët kanë të përbashkët midis tyre të qenit profesionistë në tregun ku operojnë, megjithëse risku i abuzimit me pushtetin ekonomik nuk ka të njëjtën peshë në të gjitha rastet, ai ekziston potencialisht në çdonjërin prej tyre. Të gjithë personat fizikë që ushtrojnë një profesion apo zanat, janë të nënshtruar ndaj detyrimeve të së drejtës së konsumatorit, që në momentin kur ata hyjnë në marrëdhënie juridike me konsumatorin. Për të qartësuar këtë nuancë difference midis termave, direktivat europiane përdorin një përcaktues të dyfishtëpër të cilësuar subjektet e vendosur përballë konsumatorit, që janë ata që ushtrojnë “aktivitet profesionist ose tregtar”, përcaktor i cili mbulon të gjitha rastet. E drejta e konsumatorit ka vokacionin për t’u zbatuar në të gjitha llojet e aktiviteteve profesioniste, ku gjejmë si prodhuesit, shpërndarësir, shitësit e mallrave dhe ofruesit e shërbimeve të të gjitha llojeve si ndërtues, riparues, bankier, sigurues, avokat, mjek etj. Përgjithësisht profesioni ushtrohet për të realizuar midis të tjerave edhe një përfitim, megjithatë duhet ta zgjerojmë nocionin tregtar edhe me disa aktivitete të cilat kanë të gjitha një karakter të zakonshëm dhe të organizuar, nuk kanë qëllimin të realizojnë një përfitim. Pra, qëllimi i fitimit ose jo nga veprimtaria e realizuar nuk është një element përcaktues

i termit tregtar. Arrijmë në përfundimin se, janëdy kritere kryesorë klasifikues për një person si tregtar në të drejtën e konsumatorit.²⁷

1. Ky person duhet të hyjë në marrëdhëni me një person që gëzon cilësinë e konsumatorit duke i ofruar këtij të fundit mallra apo shërbime;

2. Si person që operon në një treg të caktuar, duhet të ketë një aktivitet të organizuar dhe me karakter të zakonshëm apo të vazhdueshëm, në mënyrë të tillë që në specialitetin e tij të jetë më kompetent se konsumatori. Pra duhet të ekzistojë një disekuilibër i cili justifikon zbatimin e së drejtës së konsumatorit. A janë shërbimet publike të përfshira nga e drejta e konsumatorit? Nuk ka asnjë dyshim se për shërbimet publike me karakter tregtar ose industrial e drejta e konsumatorit është e zbatueshme. Në këto raste subjekti i së drejtës publike (shteti, ent local ose ndërmarrje publike) siguron përmbushjen e një nevojë me interes publik të përgjithshëm por, përdoruesit e shërbimit të ofruar nga ana e tyre kanë cilësinë e konsumatorit. Përsa i përket shërbimeve publike administrative të cilat janë jashtë sferës së të drejtës private, por objekt i së drejtës administrative, nga këndvështrimi teorik arrijmë në përfundimin se e drejta e konsumatorit nuk zbatohet në këto lloj shërbimesh. Megjithëse, përdoruesit e këtyre shërbimeve gjenden shpesh të pambrojtur përballë pushtetit të shërbimeve publike administrative dhe kanë nevojë për mbrojtje njëlloj si konsumatorët. Në rastin e shërbimeve administrative publike falas, që i ofrohen publikut të gjerë, përdoruesit e të cilëve nuk janë konsumatorë, përgjigja do të ishte e prerë dhe negative:

²⁷ Jean Jean Calais-Auloy dhe Frank Steinmetz në “Droit de la consommation”, DALLOZ, Botimi VI, faqe 30

IV.6 Përmbajtja e së drejtës së konsumatorit

Tërësia e të drejtave të konsumatorëve dhe detyrimeve të prodhuesve, shitësve, furnizuesve dhe ofruesve të shërbimeve përbën përmbajtjen e së drejtës së konsumatorit. Ligji kuadër i së drejtës së konsumatorit është ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për këtë arsye të drejtat dhe detyrimet e sanksionuara në të duhet të respektohen nëçdo çast të një marrëdhënieje juridike të vendosur midis konsumatorëve dhe tregtarëve.

Sanksionimi i drejtave të konsumatorëve ka për qëllim kryesor të vendosë në ekuilibër marrëdhëniet midis dy subjekteve të së drejtës së konsumatorëve me synimin përfundimtar, mbrojtjen e konsumatorit i cili presumohet në një pozitë më të dobët sesa tregtarët. Për këtë arsye ligji përcakton në fillim duke i numëruar të drejtat bazë të konsumatorëve dhe më pas detajon tërësinë e detyrimeve të tregtarëve, për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre. Në fund të fundit kështu realizohet qëllimi i tij.²⁸

IV.6.1 Të drejtat e konsumatorëve

Të drejtat e konsumatorëve sanksionohen në Ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i cili përcakton se të drejtat bazë të konsumatorëve janë:

1. E drejta e mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurisë së jetës; **2.** E drejta e mbrojtjes së interesave ekonomikë; **3.** E drejta e ankimit; **4.** E drejta për dëmshpërblim; **5.** E drejta për edukim; **6.** E drejta e njoftimit; **7.** E drejta e përdorimit të shërbimeve publike; **8.** E drejta e mbrojtjes ligjore; **9.** E drejta e organizimit në shoqata ose bashkime për mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe e drejta e përfaqësimit në organet e tyre vendimmarrëse. Ligji për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit ngarkon me përgjegjësi ligjore jo vetëm tregtarët por edhe organet shtetërore si dhe cdo person fizik apo juridik të lidhur drejtpërdrejtëose tërthorazi me çështjet e konsumatorëve. Për të bërë të mundur këtë, është e domosdoshme që subjektet e mësipërm të hartojnë dhe të ndjekin politika parandaluese për mbrojtjen e të drejtave bazë të konsumatorëve, gjithashtu duhet të kujdesen për trajtimin e tyre sidomos për kategorinë e grupeve të konsumatorëve të cilët janë më të ndjeshmit dhe më pak të mbrojturit përballë tregtarëve siç janë fëmijët, invalidët, të sëmurët etj. E drejta e konsumatorit për ankimim është një e drejtë bazë shumë e rëndësishme me ushtrimin e së cilës konsumatori bën të mundur

²⁸ Jean Jean Calais-Auloy dhe Frank Steinmetz në “Droit de la consommation”, DALLOZ, Botimi VI, faqe 31.

respektimin e të drejtave të tjera të njohura me ligj në rastin kur ato shkelen nga tregtarët. Kur konsumatori pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ai ka të drejtën të ankohet në organet shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve. Gjithashtu, ai mund të paraqesë ankesë përpara shoqatave për mbrojtjen e konsumatorëve, në mënyrë që këto me anë të kontaktit me tregtarët dhe me organet shtetërore përgjegjëse, mund të bëjnë të mundur riparimin e situatës dëmtuese për konsumatorin.²⁹

Kur konsumatorët dhe shoqatat e tyre pretendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur jo vetëm nga tregtarët por edhe/ose nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës shtetërore, ata kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Avokatit të Popullit.⁴¹ Në rast se, edhe pas ankimit pranë këtyre institucioneve nuk është riparuar situata e shkaktuar nga tregtarët dhe/ose nga organet e administratës shtetërore e cila është dëmtuese për konsumatorin ai ka të drejtë t'i drejtohet me padi gjykatës.

IV.6.2 Detyrimet e tregtarëve

Ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve” garanton të drejtat e konsumatorëve duke i parë të realizuara ato në lidhje me përmbushjen e detyrimeve në ngarkim të tregtarëve, mbi sigurinë e mallrave dhe të shërbimeve, si edhe me detyrimet e tjera të tyre, të sanksionuara në këtë ligj apo në ligje të tjera specifike. Në bazë të ligjit, tregtarët janë të detyruar t'i japin konsumatorëve të dhëna të plota për blerjen ose për përdorimin e mallrave dhe të shërbimeve që janë të përshtatshme në treg. Të vetmit persona që mund të ofrojnë një informacion të përshtatshëm për konsumatorin mbi mallin apo shërbimin janë tregtarët të cilët e hedhin në treg atë. Ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve” përcakton në mënyrë taksative cilësitë e të dhënave dhe përmbajtjen e tyre.

²⁹ Geron Ibrahim - “Kontrata e Konsumatorit. Elementet ligjore në legjislacionin shqiptar dhe europian” fq 11

V. Kontratat e Posaçme në të drejtën e konsumatorit

Ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve” rregullon disa forma të posaçme kontraktore dhe marrëdhëniet që krijohen me to, midis konsumatorëve dhe tregtarëve. Ligji u jep rëndësi përcaktuese cilësive të palëve kontraktuese, në dallim të dispozitave të përgjithshme të Kodit Civil, që i konsiderojnë ato në pozita të barabarta. Kjo nuancë në rregullimin ligjor, ndodh për arsye të mbrojtjes së interesave dhe të drejtave të konsumatorëve përkundrejt praktikave abuzive të tregtarëve. Në ligj parashikohen disa forma të kontratës së shitjes, kontratat elektronike, të

V.1 Shitja dhe ofrimi i shërbimit jashtë qendrave të tregtimit

Kontratat e shitjes dhe të ofrimit të shërbimeve jashtë qendrave të tregtimit lidhen ndërmjet shitësit, furnizuesit ose ofruesit të shërbimit dhe konsumatorit sipas një skeme të organizuar të tregtimit të drejtpërdrejtë, ose sipas një promovimi të shërbimit nga shitësi, furnizuesi ose ofruesi i shërbimeve, i cili për qëllime kontraktuale përdor një ose më shumë mjete komunikimi të drejtpërdrejtë deri në çastin e lidhjes së kontratës. Dy janë metodat e realizimit të shitjes së mallrave dhe ofrimit të shërbimeve me anë të kësaj kontrate që përdorin tregtarët. Shitja dhe ofrimi i mallrave dhe shërbimeve sipas një skeme të organizuar të tregtimit të drejtpërdrejtë, që nënkupton praninë fizike të tregtarit apo të personave të tjerë të angazhuar prej tij në ambientet e konsumatorit, gjatë situatave që nuk i përgjigjen një situatë normale tregtimi. Sipas kësaj metode, në të shumtën e rasteve, shitjet e mallrave realizohen në banesën e konsumatorit, siç është shitja e drejtpërdrejtë, paraqet një avantazh për konsumatorin pasi ai nuk zhvendoset dhe ia sjellin mallrat pranë banesës. Shitësit që e përdorin këtë metodë janë mjaft agresivë ndaj konsumatorit për ta bindur këtë të fundit të blejë produktin edhe sikur të mos e kishte ndërmend apo të mos i duhej për plotësimin e nevojave të tij. Konsumatori, i befasuar dhe nën presionin e vazhdueshëm të ofertës së shitësit për të blerë mallin, mund të marrë një vendim të gabuar në dëm të interesave të tij ekonomike duke e blerë mallin. Konsumatori nuk ka mundësinë efektive të vlerësojë krahasimisht çmimin në raport me cilësinë e mallit të ofruar dhe mallrave të tjerë të njëjtë apo të ngjashëm që janë në treg. Sipas metodës së dytë, shitja e mallrave dhe ofrimi i shërbimeve realizohet me anë të një promovimi të tyre nëpërmjet një ose më shumë mjeteve të komunikimit të drejtpërdrejtë, deri në çastin e lidhjes së kontratës. Lidhja e kontratës

realizohet me praninë fizike të shitësit dhe konsumatorit, i cili e ka pranuar propozimin e bërë nëpërmjet mjeteve të komunikimit të drejtpërdrejtë siç është televizori, telefoni, internet etj. Në të kundërt, pra kur palët nuk janë të pranishme në lidhjen e kontratës, do të zbatoheshin dispozitat ligjore që rregullojnë kontratën e shitjes në largësi apo kontratat e shitjes nëpërmjet internetit. Në thelb të kontratës së shitjes jashtë qendrave të tregtimit, është përdorimi i mjeteve të komunikimit të drejtpërdrejtë që sjellin lidhjen e kontratës në kushtet e përcaktuara në Ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorëve” Kontrata e shitjes së mallrave dhe të ofrimit të shërbimeve jashtë qendrave të tregtimit ka një rregullim të posaçëm në ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, në lidhje me detyrime të ceçanta të shitësit dhe në lidhje me përmbajtjen e saj. Ndërsa, përsa i përket aspekteve të tjera juridike, për të zbatohen dispozita të veçanta të Kodit Civil mbi kontratat dhe dispozitat e veçanta mbi kontratën e shitjes mbi kontratën e furnizimit. Shitësi, furnizuesi ose ofruesi i shërbimeve është i detyruar të përmbushë detyrimet e posaçme të Ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”. Ai ka detyrim të njoftojë me shkrim konsumatorin për të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, për emrin dhe adresën e personit ndaj të cilit do të ushtrohet e drejta e heqjes dorë. Detyrohet gjithashtu, të tërheqë mallrat e shpërndara dhe të kthejë shumat e paguara nga konsumatori, brenda tetë ditëve nga njoftimi i këtij të fundit për heqjen dorë nga kontrata. Njoftimi me shkrim i konsumatorit për mundësinë për të ushtuar të drejtën e heqjes dorë nga kontrata dhe për adresën se ku mund të drejtohet, mund të përfshihet si klauzolë në përmbajtjen e kontratës së lidhur ose mund të realizohet më pas. Në këtë rast njoftimi duhet t’i komunikohet individualisht konsumatorit. Mospërmbushja e këtyre detyrimeve të shitësit, furnizuesit apo ofruesit të shërbimit përbën kundravajtje administrative të sanksionuar me gjobë.

³⁰ Jean Calais-Auloy, “La loi sous le drapeau de la démarche à domicile et la protection des consommateurs” DALLOZ 1973, page 266.

V.2 Shitja dhe ofrimi i shërbimit në largësi

Kontratat e shitjes dhe të ofrimit të shërbimeve në largësi lidhen ndërmjet shitësit, furnizuesit ose ofruesit të shërbimit dhe konsumatorit sipas një skeme të organizuar të shitjes ose të ofrimit të shërbimit nga shitësi, furnizuesi ose ofruesi i shërbimeve, i cili për qëllime kontraktuale, përdor ekskluzivisht një ose më shumë mjete komunikimi në largësi deri në çastin e lidhjes së kontratës. Karakteristikë kryesore e kësaj kontrate është mungesa e pranisë fizike e njëkohshme e dy palëve kontraktuese, janë mjetet e komunikimit në largësi që përdoren për të bërë të mundur lidhjen e saj. Shitësi duhet detyrimisht të marrë paraprakisht pëlqimin paraprak të konsumatorit për përdorimin e mjeteve të komunikimit në largësi. Forma klasike e shitjes në largësi prej shumë kohësh ka qenë shitja me korrespondencë, ku shitësi bënte ofertat e tij nëpërmjet katalogëve, shpalljeve publike etj dhe blerësi jepte pëlqimin e tij me anë të një mjeti postal. Zhvillimet e fundit të telekomunikacionit si telefoni, faksi, televizori përdoren për të kontaktuar klientët dhe për këtë arsye përdoret edhe emri i shitjes në largësi. Shitja dhe ofrimi i shërbimit në largësi përfaqëson për konsumatorin avantazhe të mëdha, pasi në ndryshim me shitjen në dyqane ajo eviton zhvendosjen e personave dhe në krahasim me shitjen jashtë qendrave të tregtimit, e lejon konsumatorin të mendohet përpara se të marrë vendimin për të blerë. Kontrata e shitjes dhe e ofrimit në largësi paraqet disa disavantazhe për konsumatorin. Konsumatori duhet t'i nënshtrohet dhënies së informacioneve të karakterit privat mbi kërkesën e shitësve, veprim i cili përbën një ndërhyrje në jetën e tyre private. Konsumatori, me anë të kësaj kontrate vendos të blejë vetëm mbi pamjen e disa imazheve ose të disa përshkrimeve të tjeshta, gjë që përbën rrezik që ai të marrë në dorëzim një mall që nuk i korrespondon saktësisht pritshmërive të tij. Ekziston rreziku për konsumatorin që në disa raste të ndodhë që edhe pas dhënies së pëlqimit për blerje, të mos i dorëzohet malli dhe as të ketë mundësi të rimbursohet, pasi shitësi mund të jetë kthyer në insolvabël ose mund të jetë zhdukur fare. Sipas përkufizimit që jep Ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve” për shitjen në largësi nuk ka rëndësi natyra e kontratës, pavarësisht se shitet një mall ose ofrohet një shërbim, zbatohen rregullat e përcaktuara në këtë ligj, që nga momenti që një kontratë lidhet në largësi midis një tregtari dhe një konsumatori. Në kontratën e shitjes në largësi duhet të ekzistojnë dy element në mënyrë kumulative në të njëjtën kohë. Njëri element ka karakter negativ, pasi kontrata lidhet pa praninë fizike të të dy palëve. Elementi tjetër ka karakter pozitiv, për lidhjen e kontratës në largësi, palët duhet të përdorin ekskluzivisht një ose disa mjete teknike të komunikimit në

largësi.³¹ Prania e këtyre dy elementeve e dallon kontratën e shitjes në largësi nga kontrata e shitjes jashtë qendrave të tregtimit, e cila për lidhjen e saj kërkon praninë fizike të njëres prej palëve. Pavarësisht se cili është mjeti i përdorur në komunikimin në largësi, shitësi që bën propozimin duhet në çdo rast, përpara lidhjes së kontratës në largësi, të vërë në dispozicion të konsumatorit disa të dhëna. Konsumatori duhet të njoftohet për emrin dhe adresën e shitësit ose të ofruesit të shërbimit, për karakteristikat kryesore të mallit ose të shërbimit, për çmimin, sasinë, kostot që nuk janë të përfshira në çmim, për mënyrën e pagesës, mënyrën e shpërndarjes, për të drejtën për të hequr dorë nga kontrata, për kushtet se kur mund të kthehet malli ose të refuzohet shërbimi dhe për periudhën kohore gjatë të cilës oferta është e vlefshme. Këto të dhëna me karakter tregtar, duhet t'u jepen konsumatorëve të qarta dhe të kuptueshme. Ligji "Për mbrojtjen e konsumatorëve" nuk shprehet se cila është pasoja ligjore përsa i përket përgjegjësisë civile kur mungon një nga këto të dhëna detyruese. Konsumatorit, në raste të tilla i lind e drejta të kërkojë pavlefshmërinë e kontratës përpara gjykatës, për arsye se vullneti i tij është i metë, pasi nuk ka ditur të dhënat e nevojshme përpara lidhjes së kontratës. Tregtarët, përveç përgjegjësisë civile, kanë përgjegjësi administrative në rast se nuk përmbushin detyrimin për ofrimin e të dhënave të mësipërme, pasi ligji "Për mbrojtjen e konsumatorëve" e tregon kundravajtje administrative mosveprimin e tyre. Gjatë zbatimit të kontratës në largësi dhe jo më vonë se përfundimi i afatit të zbatimit të saj, konsumatori duhet të marrë konfirmim me shkrim nga shitësi dhe ofruesi i shërbimeve edhe për kushtet dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës për të hequr dorë nga kontrata. Gjithashtu, duhet të njoftohet për adresën se ku mund të drejtojë kundërshtimet, për shërbimet pas shitjes dhe të garancionit nëse ka, si dhe për zgjidhjen e kontratës. Përveç të dhënave detyruese që përmenden në ligj, përsa i përket kontratës në largësi, tregtarët në të njëjtën kohë duhet të përmbushin edhe detyrimin për dhënien e informacionit të përgjithshëm, detyrim të cilin e parashikojnë dispozitat e përgjithshme të ligjit "Për mbrojtjen e konsumatorëve". Pavarësisht se me çfarë mjeti të komunikimit në largësi është bërë oferta, propozimi apo pranimi, në çdo rast konsumatori angazhohet juridikisht në një kontratë të tillë vetëm me anë të dhënies së nënshkrimit të tij, menjëherë pasi ka dhënë konfirmimin për propozimin e bërë nga tregtari. Ky moment është i rëndësishëm për arsye se me të lidhet edhe pasoja e (pa)vlefshmërisë së kontratës në largësi. Mungesa e miratimit të konsumatorit sjell pavlefshmërinë absolute të kontratës në largësi. Momenti i lidhjes së kontratës në largësi është

³¹ Jean Jean Calais-Auloy dhe Frank Steinmetz në "Droit de la consommation", DALLOZ, Botimi VI, faqe 112

shumë i rendësishëm, pasi me të lidhen një sërë të drejtash dhe detyrimesh të të dyja palëve kontraktuese, siç është e drejta e heqjes dorë nga kontrata.

V.3 E drejta për të hequr dorë nga kontrata

Në kontratën e shitjes dhe të ofrimit të shërbimit jashtë qendrave tregtare dhe në kontratën e shitjes dhe të ofrimit të shërbimit në largësi, konsumatori, prezumohet se nuk ka mundësinë reale të marrë vendimin e duhur për të blerë mallrat dhe shërbimet. Kjo ndodh për shkak se këto kontrata lidhen në kushte dhe në situata të ndryshme nga ato të përditshmet në të cilat është mësuar të veprojë konsumatori. Ai nuk mund të krahasojë mallin që blen me një mall të njëjtë apo të ngjashëm me të në treg, ose nuk mund të vlerësojë cilësinë dhe karakteristikat thelbësore të tij.³²

Për këto arsye, ligjvënësi e ka vlerësuar si të nevojshme të parashikojë një mbrojtje të posaçme dhe të përshtatshme për konsumatorin, duke parashikuar në favor të tij të drejtën për të hequr dorë nga lidhja e kontratës, brenda një afati 7 ditor. E drejta për të hequr dorë nga lidhja e kontratës është një e drejtë e njohur edhe në Kodin Civil, në rastin kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e përcaktuara në të. Konsumatori ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata e lidhur në largësi pa iu nënshtuar sanksioneve dhe pa dhënë shpjegime, brenda një periudhe prej 7 ditësh kalendarike nga dita e marrjes së mallit ose e lidhjes së kontratës për shërbim, me kusht që brenda këtij afati shërbimi të mos jetë kryer.

³² Jean Jean Calais-Auloy dhe Frank Steinmetz në “Droit de la consommation”, DALLOZ, Botimi VI, faqe 120

V.4 Nevoja e mbrojtjes së konsumatorit

Mbrojtja e konsumatorit, për çdo shtet, rrjedhimisht shoqëri të organizuar, jo vetëm që është një sferë dhe problematikë më rëndësi dhe peshë të veçantë, por edhe komponentë po aq relevante dhe me ndikim të përhershëm në ecuritë dhe kahjet e zhvillimit ekonomik e shoqëror. Shkallë e zhvillimit të të drejtave të konsumatorit, parimisht është rrjedhojë dhe rezultat i një shkalle të caktuar dhe në rrethana e ambient të caktuar të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe social të një vendi, që do të thotë është karakteristikë e vendeve të zhvilluara dhe demokratike. Pikërisht duke u bazuar në këtë frymë dhe në Rezolutën nr.39/248, të datës 09.04.1985 Asambleja e përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ka miratuar Udhëzimin mbi mbrojtjen e konsumatorit i cili u jep qeverive korniza dhe mundësi për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacioneve për mbrojtjen e konsumatorit. Po kështu, vendet nënshkruese të Traktatit për themelimin e Bashkimit Evropian në Romë (Traktati është lidhur në vitin 1957), në fund të vitit 1973, do të miratojnë Kartën evropiane për informimin dhe mbrojtjen e konsumatorëve, duke përfshirë të drejtat e tyre, që kishin të bënin me interesat ekonomike, me të drejtat për mbrojtje nga rreziqet e jetës dhe të shëndetit, të prodhimeve dhe shërbimeve në treg, të drejtat për mbrojtje juridike dhe përkrahje të shtetit. Sipas dispozitave të shumë shteteve anëtare, sikurse u trajtua në punim, po kështu do të trajtohet më në detaje edhe në këtë kapitull, konsumatorë është çdo person fizik, që blen dhe përdor mallra ose shërbime për plotësimin e nevojave të veta dhe jo për qëllime që janë të lidhura me veprimtari tregtare, respektivisht për rishitjen e atyre mallrave. Politika e mbrojtës së konsumatorit mbulon një fushë të veprimit, e cila, është sa unike, dinamike e specifike, po aq edhe e gjerë dhe vitale. Komponentët më qenësore të politikës konsumuese në rend të parë janë mbrojtja e plotë e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse e pozitës, rrjedhimisht e të drejtave, nevojave dhe kërkesave të konsumatorit

V.5 Parimet e Bashkimit European për Mbrojtjen e Konsumatorit

Parimet themelore për mbrojtjen e konsumatorit janë bazë kryesore orientuese në të cilën ndërtohen dhe zbatohen politikat për mbrojtjen e konsumatorëve të një vendi. Mirëqenia e konsumatorit (consumer welfare) është koncept më i gjerë se mbrojtja e konsumatorit (consumer protection). Mund të thuhet se mirëqenia e konsumatorit është forcë shtytëse e politikës së konkurrencës të çdo shteti. Pra synim i çdo shteti demokratik është mbrojtja e konsumatorit. Parimet themelore të politikës për mbrojtjen e konsumatorit janë: - Parimi i prioritetit; - Parimi i bashkëpunimit, koordinimit, përgjegjësisë dhe llogaridhënies; - Parimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes efikase dhe efektive; - Parimi gjithëpërfshirës; dhe - Parimi i parandalimit.

Bashkimi European, si një organizatë rajonale e organizuar dhe e avancuar, veçanërisht si një treg i lirë dhe ndër tregjet më të mëdha në botë, duke pasur në konsideratë seriozisht dinamikën zhvillimore ekonomike, brenda strukturës së saj, por edhe jashtë saj, mbrojtjes së konsumatorëve, i ka kushtuar vëmendje parësore. Në këtë drejtim kjo organizatë ka krijuar dhe proklamuar edhe parimet e veçanta në mbështetje të të cilave, nëpërmjet akteve të ndryshme juridike, siç janë ndër të tjera edhe me dhjetë direktiva, realizohet dhe gjithnjë e më tepër avancohet niveli dhe cilësia e mbrojtjes së konsumatorëve evropianë. Çështja e mbrojtjes së konsumatorit, gjykuar sipas parimeve të mësipërme, por mbrojtja e konsumatorëve edhe si çështje e të drejtave të njeriut është e përcaktuar po ashtu edhe në ligjet dhe praktikën më të mira të BE-së, të pasqyruara në dhjetë parimet e mbrojtjes së konsumatorit, por edhe Direktivën 1999-44-EC. Politika e konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorit janë politikat komplementare të cilat reciprokisht plotësojnë njëra tjetrën edhe pse ata kanë perspektiva të ndryshme dhe shfrytëzojnë mjete të ndryshme për të arritur qëllimin e përbashkët. Këto kanë qasje të ndryshme por qëllimi është i njëjtë: një treg konkurrues në të cilën është i sigurt sovraniteti i konsumatori dhe mirëqenia e tij. Për shkak të këtyre raporteve mjaft komplekse dhe tensioneve të vazhdueshme që ekzistojnë mes tyre kërkohet analiza dhe monitorim të vazhdueshëm. Ekziston parimi se "Mbrojtja më e mirë për konsumatorin është konkurrenca e zhvilluar", mirëpo në shumicën e rasteve nivel i lartë i konkurrencës nuk është i mjaftueshëm. Me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit është e nevojshme që rregullave në fushën e mbrojtjes së konkurrencës tu bashkëngjiten edhe rregullat nga fusha e mbrojtjes së konsumatorit. Kështu që do të arrihej një balancim i raporteve në mes të konsumatorit dhe pjesëmarrësve tjerë të tregut. Në kushtet e konkurrencës së tregut, tregtarët janë të vetëdijshëm se konsumatori ka mundësi të bëjë

³³ zgjedhje të ndryshme prandaj përpiqen që të sigurojnë ofertat me qëllim të parandalimit të përzgjedhjes së konkurrentit tjetër. Ata u ofrojnë konsumatorëve një përzgjedhje të gjerë me çmime konkurruese. Në kushtet e një sistemi të zhvilluar të mbrojtjes së konsumatorit, konsumatorët janë më të informuar, të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe mundësitë e zbatimit të tyre dhe me presionin e vazhduar mbi shitësit i shtyn ata drejtë një konkurrence të drejtë. Duke pasur parasysh ndërlidhjen e politikës së konkurrencës dhe politikës së mbrojtjes së konsumatorit që nënkupton se niveli i mirëqenies së konsumatorëve është në përputhje me nivelin e zhvillimit të konkurrencës në treg, është jashtëzakonisht e rëndësishme për të forcuar vetëdijes dhe të kuptuarit se: - Çdo gjë që shtrembëron konkurrencën dhe dëmton pozitën e konsumatorit, dhe; - Ajo që forcon mirëqenien e konsumatorit forcon edhe konkurrencën. Rregullat nga fusha e mbrojtjes së konsumatorit në radhë të parë janë të destinuara për parandalimin e dëmtimit të konsumatorëve, si individualisht ashtu dhe kolektivisht, si dhe mënyrat e mbrojtjes së të drejtave, nëse vjen deri tek shkelja e tyre. Këto rregulla parandalojnë sjelljen e padrejtë të 54 shitësit kundrejt konsumatorit. Krijimi i një mjedisi të mirëfilltë të biznesit në tregun e brendshëm, zhvillimi i konkurrencës në mesin e ndërmarrjeve, sjell nivele të larta të mbrojtjes së konsumatorit me qëllim të rritjes së vetëdijesimit mbi mbrojtjen e konsumatorëve.

V.6 Parashikime të përgjithshme të Direktivës “Mbi Kushtet e Padrejta në Kontratat Konsumatore”

Në këtë pjesë të punimit do të trajtohen parashikimet kryesore lidhur me kushtet e padrejta në kontratën konsumatore, sipas direktivave thelbësore të BE dhe mënyrës së implementimit të tyre

në shtetet anëtare. Direktivës 93/13 KEE mbi Kushtet e Padrejta në Kontratat Konsumatore aktualisht i është dhënë fuqi përmes Rregulloreve të Komunitetit Europian të 1995 dhe 2000 (Mbi kushtet e padrejta në kontratat konsumatore), Rregullorja e 2013-tës dhe Rregullorja e 2014 (Mbi Amendamentet)¹⁷⁴. Në pikëpamje të qëndrueshmërisë së Direktivës për të drejtat kontratore të konsumatorit, është një rast bindës për përfshirjen e tij në legjislacionin e propozuar. Direktiva mbi Kushtet e Padrejta është një nga aktet më të rëndësishme të Acquis së BE mbi konsumatorin. Paragrafi 9 i Direktivës parashikon se ka si qëllim mbrojtjen e

³³ Brandner, H. and Ulmer, P. 'The Community Directive on Unfair Terms in Consumer Contracts: Some Critical Remarks on the Proposal Submitted by the EC Commission', Common Market Law Review 647

konsumatorëve që marrin shërbime dhe mallra, kundrejt abuzimit të fuqisë së shitësit apo furnizuesit, në veçanti kundrejt standarteve të njëanshme të kontratave dhe përjashtimeve të padrejta të të drejtave themelore në kontratë. Pavarësisht rëndësisë së saj Direktiva është e shkurtër dhe konçize. Dispozitat kryesore mbi fushën e zbatimit të Direktivës lidhen inter alia me kriteret e vlerësimit të kushteve të padrejta në kontratë, transparencën e kushteve të kontratës dhe efektet e padrejtësisë së tyre të parashikuara në pesë nene të shkurtra dhe konçize.

V.7 Fusha e zbatimit të Direktivës mbi Kushtet e Padrejta

Parashikimi i parë në kuadër të fushës së aplikimit të Direktivës lidhet me faktin se ajo nuk aplikohet për kushtet e kontratës, të cilat janë “negociuar individualisht”.¹⁷⁵ Neni 3/2 sqaron se një kusht duhet të shihet gjithmonë si i panegociuar individualisht “kur është hartuar paraprakisht dhe si pasojë, konsumatori nuk ka patur mundësi të ndikojë në përmbajtjen e kushtit, veçanërisht në kuptim të kontratave standard të para-hartuara.”

V.8 Nivel më i lartë i mbrojtjes së konsumatorit.

Parimi Komisionit përbën një argument të tretë për harmonizimin maksimal, atë që do t'i ofronte “konsumatorëve një nivel të lartë të përbashkët të mbrojtjes së tyre”. Në këtë kuadër, mund të jepet një përgjigje e shkurtër lidhur me mbrojtjen më të lartë të konsumatorëve: kjo reflekton një lloj paternalizmi ligjor që qartë nuk respekton dallimet kombëtare lidhur me kulturën ligjore. Komisioni mendon me arrogancë se e di më mirë se cilat rregulla ligjore janë të përshtatshme për shumicën e qytetarëve në veçanti për Shtetet Anëtare. Prandaj, përfitimet e një qasjeje të diferencuar duhet kështu të sakrifikohen.³⁴ Duke pasur parasysh dallimet në kulturën juridike sa i përket të drejtave kontraktore të konsumatorëve mund të pritet që ky “nivel i lartë i përbashkët i mbrojtjes së konsumatorit” mund të jetë shumë i ulët për Shtete Anëtare të veçanta dhe shumë e lartë për të tjera. Sa i përket kategorisë së parë: përgjigjet e para të propozimit të Komisionit të publikuara, për shembull, në Holandë ishin jashtëzakonisht kritike, duke argumentuar se futja e këtij propozimi në mënyrë efektive do të çonte në uljen e nivelit të mbrojtjes së konsumatorit. Për Shtetet e tjera Anëtare (veçanërisht ato në Europën Lindore), mund të pritet se “niveli i lartë i përbashkët i mbrojtjes së konsumatorit” i imponuar nga ky

³⁴ S. Eatherill, E.U. consumer law and policy, 2005, fq. 64–66

propozim shkon shumë më tepër se niveli aktual i mbrojtjes së konsumatorit. Në këtë kuadër, duhet të mbahet mend se Teorema e Coase tregon se ka gjithmonë një marrëdhënie midis një “niveli të lartë të përbashkët të mbrojtjes së konsumatorit” dhe çmimeve të produkteve dhe shërbimeve. Rritja e mbrojtjes gjithmonë vjen me koston e rritjes së çmimeve të produkteve dhe shërbimeve. Vendimi paternalist i burokratëve në Bruksel më tej udhëheq në situatën që këta burokratë me sa duket besojnë se e dinë më mirë se çfarë niveli i duhur i mbrojtjes së konsumatorit është në Lituani, Danimarkë dhe Portugali, ndërsa një perspektivë ekonomike sugjeron që autoritetet lokale kanë më shumë gjasa të kenë informacion më të mirë për të krijuar rregulla që korrespondojnë më mirë me preferencat e qytetarëve në ato Shtete Anëtare. Ndaj, një nivel i lartë i mbrojtjes së konsumatorit më vete nuk mund të sigurojë një justifikim adekuat për ndërhyrjen europiane

V.9 Përkufizimi i konsumatorit

Sikurse u trajtua ut supra mbi konceptin e konsumatorit sipas jurisprudencës së GjED mbi parashikimet e Direktivës, në këtë pjesë të punimit shihet shkurtimisht Neni 2 (b) i Direktivës 93/13 i cili përcakton konsumator çdo person fizik i cili vepron me qëllime të cilat janë jashtë tregtisë, biznesit apo profesionit të tij. Shtetet anëtare e kanë ndjekur vetëm pjesërisht këtë përkufizim. Në një numër shtetesh anëtare gjenden përkufizime të devijuara të konsumatorit. Në Spanjë, Greqi dhe Hungari të gjithë “adresuesit e fundit” mbrohen si konsumatorët. Në shumicën e rasteve, ky koncept ofron mbrojtje më të gjerë se Direktiva 93/13, pasi ajo gjithashtu përfshin transaksione atipike, të cilat nuk lidhen me një transferim të mëtejshëm. Në Francë, Poloni dhe Letoni bizneset që lidhin kontrata që nuk lidhen drejtpërdrejt me profesionin e tyre, mbrohen gjithashtu si “konsumatorë” ose “jo-profesionistë”²⁶⁵. Në Austri, Belgjikë, Republikën Çeke, Danimarkë, Francë, Greqi, Hungari, Sllovaki dhe Spanjë, personat juridikë trajtohen si konsumatorë, me kusht që blerja të jetë përdorim privat ose (në Greqi, Hungari dhe Spanjë) personi juridik është personi i fundit i adresuar. Në Hungari ka patur projekte që planifikonin të kufizojë nocionin e konsumatorit tek personat fizikë. Në Portugali, është e paqartë nëse personat juridikë mund të mbrohen si “konsumatorë”, megjithatë, drafti i një Kodi të ri të Konsumatorit

pranon se personat juridikë munden, në disa raste dhe rrethana, të përfitojnë nga mbrojtja e dhënë konsumatorëve. Ligji në Rumani mbron grupe personash fizikë, të organizuar në shoqata . Në Maltë, çdo klasë ose kategori tjetër e personave, qoftë fizikë apo juridikë, mund nga koha në kohë, të përcaktohet si “konsumatorë” për të gjitha ose ndonjë nga qëllimet e Aktit të Çështjeve të Konsumatorit nga Ministri përgjegjës për çështjet e konsumatorëve pas konsultimit me këshillin e Çështjeve të Konsumatorit. Për më tepër, në Maltë nocioni i “konsumatorit” përfshin çdo individ tjetër që nuk është blerësi i menjëhershëm ose përfitues, qoftë anëtar ose jo i familjes së konsumatorit, i cili, duke qenë shprehimisht ose në formë të heshtur i autorizuar ose i lejuar nga konsumatori, mund të ketë konsumuar, përdorur ose përfituar nga ndonjë mall apo shërbim që i është ofruar konsumatorit nga tregtari.

V.10 Përkufizimi i shitësit ose furnizuesit

